



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 19.09.2022)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 119, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:48 dhe mbaroi në orën 13:57.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami*** (kryetare)
- 2. Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
- 3. Klodian Kurushi*** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli*** (anëtare)
- 5. Irena Plaku*** (anëtare)
- 6. Dritan Hallunaj*** (anëtar)
- 7. Ridvan Hado*** (anëtar)
- 8. Alban Toro*** (anëtar)
- 9. Brikena Ukperaj*** (anëtare)
- 10. Marçela Shehu*** (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashë.*
- 2. Denisa Varfi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 3. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 4. Përfaqësues nga Universiteti “Epoka”.*
- 5. Staf administrativ i KLGJ-së; Media KLGJ.*
- 6. Valbona Bala, USAID.*
- 7. Edmond Hoxhaj.*

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 119, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Rifillon mbledhja plenare pas trajtimit të çështjes së parë të rendit të ditës e cila u trajtua vetëm në prezencën e anëtarëve të Këshillit.

Naureda Llagami: Vazhdojmë me çështjen e dytë të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 119, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Fjala për zotin Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit Kryetare!

Paraqesim relacionin e radhës që ka për objekt projektvendimin “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për

Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 119, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, pas plotësimit të kuadrit ligjor nëpërmjet miratimit të akteve nënligjore të autorizuar nga ligji, në ushtrim të përgjegjësisë për mbarëvajtjen e sistemit gjyqësor (neni 147, pika 1, e Kushtetutës) dhe në veçanti të funksionit të ngritjes në detyrë të gjyqtarëve të të gjitha niveleve (neni 147/a, pika 1, shkronja “a”, i Kushtetutës), në kuadër të plotësimit të pozicioneve të lira në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ka hapur procedurat e ngritjes në detyrë, ndër të tjera, edhe për 3 (tre) pozicionet e lira, respektivisht me Vendimin nr. 117, Vendimin nr.118 dhe Vendimin nr.119, datë 01.04.2021.

Në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira si më sipër, brenda afateve të kandidimit, që përfunduan respektivisht në datën 16.04.2021 kandiduan gjithsej 2 (dy) kandidatë dhe konkretisht: znj. {...} dhe z. {...}. Konkretisht, kandidimet për këto pozicione të lira paraqiten në formë tabelare si më poshtë:

Vendimi nr. 117, Vendimi nr. 118, Vendimi nr. 119. Për vendimin nr. 117, nr. 118 dhe nr. 119 ka paraqitur kërkesë zonja {...}, ndërsa për vendimin nr. 119 të shpallur, ka paraqitur kërkesë, përveç znj. {...} edhe z. {...}.

Sipas pikës 9, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016, në një procedurë ngritjeje në detyrë për një pozicion të lirë, Këshilli i Lartë Gjyqësor bën renditjen e kandidatëve që përmbushin kriteret, renditje kjo që bëhet në funksion të përzgjedhjes së kandidatit të renditur më lart, i cili do të duhet të ngrihet në detyrë në atë pozicion të lirë.

Për të evidentuar kandidatët që përmbushnin kriteret e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Këshilli realizoi procedurat e verifikimit të plotësimit nga secili kandidat të kriterëve të më poshtme:

1) “përvojës profesionale minimale”, sipas shkronjës “b”, pika 2, të nenit 47, të Ligjit për Statusin;

2) “mospasjes masë disiplinore në fuqi”, sipas pikës 8, të nenit 48, të Ligjit për Statusin;

3) “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”, sipas nenit 8, të Ligjit për Statusin;

4) “dhënies së pëlqimit (ai/ajo edhe familjarët e afërm) për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”;

5) verifikimi i pasurisë dhe figurës, sipas pikave 7 dhe 8, të nenit 48, të Ligjit për Statusin.

Për plotësimin në kohë të pozicioneve të lira, ndër të tjera, edhe në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Këshilli, në të gjitha procedurat e ngritjes në detyrë në gjykatat më të larta ose të specializuara, ka konsideruar zhvillimin paralelisht të procedurës së verifikimit të kriterëve të kandidimit, me atë të vlerësimit etik dhe profesional të kandidatëve për secilin nga pozicionet e lira.

Në rastin konkret është bërë verifikimi i të gjithë kriterëve ligjore dhe pas përfundimit të verifikimit të të gjithë kriterëve ligjore për të dy kandidatët, Këshilli i Lartë Gjyqësor bëri verifikimet dhe verifikoi plotësimin nga ana e tyre, duke vendosur kualifikimin e tyre dhe vijimin e procedurave të mëtejshme për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira respektive ku ata kanë kandiduar.

Për znj. {...}, Këshilli ka vendosur kualifikimin e kandidates dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë, me Vendimin nr. 228, datë 02.06.2021;

Për z. {...}, Këshilli ka vendosur kualifikimin e kandidatit dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë, me Vendimin nr. 355, datë 09.09.2021;

Siç u parashtrua, krahas procedurave të verifikimit të kriterëve të kandidimit, paralelisht, për kandidatët kanë vijuar edhe procedurat e vlerësimit etik dhe profesional, konkretisht: 1) vlerësimi me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016 2) vlerësimi i përshpejtuar për vitin 2019.

Është përfunduar edhe vlerësimi profesional për të dy kandidatët të cilët në nivelin e vlerësimit (të dy vlerësimet e përmendura më lart), kanë dalë me vlerësimin "Shkëlqyeshëm".

Njëkohësisht, për vijimin e procedurës mbi kushtet dhe kriteret e kandidimit kemi verifikuar, për kandidatën znj. {...} administrimin e dy vlerësimeve dhe faktin që, si kandidatja {...}, ashtu edhe kandidati {...} nuk kanë pasur kontestime në lidhje me procesin e vlerësimeve etike dhe profesionale.

Duke e konsideruar të plotë kuadrin ligjor që i referohet kushteve dhe kriterëve ligjore për të proceduar më tej si Këshill për renditjen e kandidatëve, duke vijuar më tej në procedurën e përzgjedhjes për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 119, datë 01.04.2021, konstatojmë që janë përfshirë dy kandidatët të cilët kanë shfaqur interes, që janë zonja {...} dhe zoti {...}.

Për këta kandidatë u verifikua plotësimi i dy kërkesave të ligjit për të qenë pjesë e procedurës së përzgjedhjes për këtë pozicion të lirë, në kushtet kur ata ishin kualifikuar në procedurën e ngritjes në detyrë ndërsa plotësonin kriteret e kandidimit, si dhe kishin dy vlerësime etike dhe profesionale.

Për renditjen e kandidatëve, fillimisht u ndoq hapi i parë i renditjes, ku për secilin kandidat u bë një vlerësim krahasues i treguesve të kriterëve dhe përparësive të përcaktuara dhe të renditura në nenin 48, pika 9, shkronja “a”, të Ligjit për Statusin, si dhe të detajuara në Seksionin B, Kreu IV, të Vendimit 70/2020.

Siç u parashtrua, në pikën 9, të Ligjit për Statusin, përcaktohet se: “9. Këshillat shqyrtojnë kandidimet dhe rendisin kandidatët që përmbushin kriteret, sipas rezultateve të mëposhtme: a) së pari, dy vlerësimet e mëparshme, ...”. Ndërsa në pikën 12, të Vendimit 70/2020, përcaktohet se: “Renditja e kandidatëve bazohet në vlerësimin krahasues të niveleve të dy vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale. Kandidati me nivelet më të larta të vlerësimit etik dhe profesional, renditet më lart”.

Referuar kriterit të parë të renditjes, pra atij sipas “niveleve të dy vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale”, për kandidatët u konstatua:

a) Për znj. {...} - Sipas Vendimit të Këshillit nr. 240, datë 30.06.2022, kandidatja është vlerësuar/graduar për periudhën e vlerësimit 2013-2016, në nivelin e përgjithshëm “Shkëlqyeshëm”; Sipas Vendimit të Këshillit nr. 257, datë 15.07.2022, kandidatja është vlerësuar për vitin 2019, në nivelin e përgjithshëm “Shkëlqyeshëm”, pasi është bërë njohja e vlerësimit etik dhe profesional të kryer nga Shkolla e Magjistraturës dhe konvertimi i këtij vlerësimi.

b) Për z. {...} - Sipas Vendimit të Këshillit nr. 553, datë 01.12.2021, kandidati është vlerësuar/graduar për periudhën e vlerësimit 2013-2016, në nivelin e përgjithshëm “Shkëlqyeshëm”; Sipas Vendimit të Këshillit nr. 534, datë 01.12.2021, kandidati është vlerësuar për vitin 2019, në nivelin e përgjithshëm “Shkëlqyeshëm”.

Nga zbatimi i kriterit të parë të renditjes, pra atij sipas “niveleve të dy vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale”, rezultoi që kandidatja znj. {...} dhe kandidati z. {...}, të kenë “Shkëlqyeshëm” dy nivelet e vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale. Nga vlerësimi krahasues i niveleve të dy vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale për kandidatët, duke pasur parasysh pesë nivelet e vlerësimit sipas pikës 1, të nenit 78, të Ligjit për Statusin, nuk arrihet të identifikohet kandidati me rezultatet më të larta. Pra, duke iu referuar këtij kriteri renditjeje, është e pamundur renditja e dy kandidatëve me rezultate të njëjta më të larta, duke mos u arritur kështu bërja e renditjes së plotë të kandidatëve, për të identifikuar kandidatin e renditur më lart.

Në vijim të shkronjës “a”, të pikës 9, të nenit 48, të Ligjit për Statusin, siç u parashtrua, referuar përparësisë së parë për kriterin e parë të renditjes, pra asaj sipas “nivelet të vlerësimit të fundit”, nisur nga sa më lart u parashtrua, për dy kandidatët u konstatua që kanë të njëjtin nivel vlerësimi, “Shkëlqyeshëm”, për vlerësimin e fundit etik dhe profesional, pra atë të vitit 2019. Për pasojë, rezultoi e pamundur renditja e kandidatëve sipas kësaj përparësie.

Referuar përparësisë së dytë për kriterin e parë të renditjes, pra asaj sipas “përvojës si gjyqtar i komanduar, si gjyqtar në skemën e delegimit, ose si anëtar i Këshillit”, u konstatua se njëri nga dy kandidatët me rezultate, nivele të njëjta vlerësimi etik dhe profesional, ka përvojë të tillë që e kërkon dispozita ligjore. Konkretisht z. {...} nga viti 2016 - vitin 2020 ka qenë i komanduar si ndihmësmagjistrat në Gjykatën e Lartë pasi KLD-ja me Vendimin nr. {...}, datë 04.11.2016, ka vendosur komandimin e gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor {...}, {...}, si ndihmës ligjor pranë Gjykatës së Lartë dhe KLGJ-ja me vendimin nr.227, datë 22.10.2019 ka zgjatur mandatin e komandimit edhe me 1 vit. Pas përfundimit të kohëzgjatjes së komandimit, z. {...} është caktuar në skemën e delegimit prej nëntorit 2020 dhe ricaktuar sërish në nëntor të vitit 2021. Aktualisht zoti {...} ndodhet në skemën e delegimit.

Nga ana tjetër znj. {...} me vendimin nr.225, datë 22.10.2019 të KLGJ-së është komanduar në pozicionin e pedagogut të brendshëm në Departamentin e Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës, për një afat 5-vjeçar. Afati i komandimit fillon më datë 15 nëntor 2019, pra siç rezulton nuk ka përfunduar afati i komandimit.

Në pikën 8, të Vendimit 70/2020, përcaktohet se: “Renditja e kandidatëve bëhet me qëllim përzgjedhjen e kandidatit më të mirë për pozicionin e lirë”. Kurse në pikën

15, të këtij vendimi, përcaktohet se: “Në rast se ka më shumë se një kandidat me rezultate të njëjta, për renditjen e kandidatëve me rezultatet më të larta zbatohen përparësitë sipas radhës së mëposhtme: ...; b) “përvoja si gjyqtar i komanduar, si gjyqtar në skemën e delegimit, ose si anëtar i Këshillit” - Sipas kësaj përparësie, kandidati që ka një nga këto përvoja, renditet më lart; ...”.

Nisur nga përcaktimet pikave 8 dhe 15/b, të Vendimit 70/2020, rezulton se nga zbatimi i përparësisë së dytë për kriterin e parë të renditjes, pra asaj sipas “përvojës si gjyqtar i komanduar, si gjyqtar në skemën e delegimit, ose si anëtar i Këshillit”, arrihet të identifikohet kandidati me rezultatet më të larta, pikërisht z. {...}. Pasi ka të përfunduar një mandat komandimi dhe zgjatjen e tij, si edhe një periudhë të plotë delegimi. Ndërsa znj. {...} nuk e ka përfunduar periudhën e komandimit. Mbi këtë bazë arrihet të bëhet renditja e kandidatëve, ku më lart renditet kandidati z. {...}, ndërsa kandidatja e dytë renditet zonja {...}.

Për pasojë renditja e kandidatëve për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 119, datë 01.04.2021 është si më poshtë:

- 1) Z. {...};
- 2) Znj. {...}.

Bazuar në sa më lart, relatori përgatiti projektvendimin “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 119, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Sipas pikës 1 të projektvendimit, Këshillit i propozohet të miratojë renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 119, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë: 1) Z. {...}; 2) Znj. {...}.

Në pikën 2 të projektvendimit përcaktohet se një kopje e arsyetuar e vendimit iu njoftohet kandidatëve Z. {...} dhe Znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Në pikën 3 të projektvendimit përcaktohet se kundër vendimit mund të bëhet ankim nga çdo kandidat, në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit.

Së fundi, në projektvendim përcaktohet se ky vendim botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Projektvendimi “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 119, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, u shqyrtua nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës në mbledhjen e datës 09.09.2021.

Ky është relacioni dhe bashkëlidhur relacionit ne kemi paraqitur edhe projektvendimin të cilin unë e përmenda në relatimin përkatës dhe që është i ndarë në tre pika kryesore.

Faleminderit për vëmendjen!

Naureda Llagami: Faleminderit zoti Kurushi!

Atëherë, ftoj kolegët, nëse nuk kanë ndonjë diskutim.

Brikena Ukperaj: Unë jam dakord me relacionin e përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, por dua të theksoj se ndoshta për herë të parë ne po aplikojmë këtu përparësi për shkak të skemës së delegimit, dhe nga sa kuptoj nga relacioni, zoti {...} ka përfunduar tërësisht periudhën 5-vjeçare të komandimit, pra e ka të mbaruar tërësisht dhe veç kësaj ka të mbaruar 1 vit skemë delegimi. Zgjatja është bërë për shkak të nevojave që ka pasur Këshilli dhe ndërkohë ai ka aplikuar gjatë kohës që ka qenë në vitin e dytë të skemës së delegimit. Pra ai ka pasur përveç kohëzgjatjes, ka pasur edhe shumëllojshmëri të pozicioneve mbi të cilat ka përparësi (pra komandimin dhe skemën e delegimit).

Për ta pasur më të qartë, në fakt, unë do të doja që në preambulën e projekt-aktit, ne të shtonim nenin 57, pika 3 e ligjit, e cila përcakton shprehimisht: “Që Këshilli të marrë në përparësi komandimin e gjyqtarit, duhet që ai ta ketë përfunduar tërësisht periudhën e komandimit sepse zonja {...} ka qenë në procedurë komandimi dhe nuk e ka përfunduar procedurën e komandimit. Ky është dallimi që bëhet midis të dy kandidatëve.

Nëse Këshilli do ta vlerësojë atë çka shkruhet në relacion, duhet të themi neni 57, pika 3 dhe duhet të citohet në preambulën e aktit “...neni 48 dhe 57, pika 3...”. Sepse mund të ketë kontestime nga ana e kandidatës.

Marçela Shehu: Atëherë Brikena, vetëm 57?

Brikena Ukperaj: 57, pika 3.

Marçela Shehu: Që flet për komandimin.

Për skemën e delegimit?

Brikena Ukperaj: Për skemën e delegimit nuk ka një specifikë në ligj që thotë që duhet ta ketë përfunduar tërësisht afatin e skemës së delegimit.

Marçela Shehu: E kuptoj, por duke qenë se ne përfshijmë 57 këtu që flet për komandimin dhe për kohëzgjatjen e plotë, atëherë mbase në preambulë të citojmë edhe dispozitën për skemën e delegimit ku parashikohet që përbën vlerë të shtuar...

Brikena Ukperaj: E kanë përcaktuar nenin 48.

Marçela Shehu: Është tek 48?

Brikena Ukperaj: Po! Është tek 48.

Por 57, pika 3 duhet sepse mund të ketë edhe ankimim.

Që do të thotë që periudha e komandimit merret parasysh vetëm në qoftë se ti e ke përfunduar tërësisht.

Klodian Kurushi: Pjesëmarrja e zotit {...} në skemën e delegimit nuk është përfshirë si kriter përparësie midis dy kandidatëve. Ne kemi marrë kriterin e përparësisë referuar faktit që ata janë të dy në skemën e komandimit dhe duke qenë të dy në skemën e komandimit, zoti {...} e ka përfunduar mandatin e plotë të skemës së komandimit, ndërsa zonja {...} është në skemë komandimi dhe nuk e ka përfunduar mandatin e saj.

Ndodhur përpara kësaj situate, ne themi që ka përparësi në bazë të ligjit dhe në bazë të vendimit nr. 70 që unë e përmenda, kandidati i cili ka përfunduar tërësisht skemën e komandimit. Pjesa e përfshirjes së kandidatit në skemë delegimi është vetëm një situatë për t'ia bërë të ditur sot mbledhjes që gjyqtari {...} sot ndodhet në skemë delegimi, pra

ushtron funksionet si gjyqtar, por i përfshirë në skemën e delegimit. Nuk është pjesë e përparësive dhe nuk e marrim si pikë në relacion që shton përparësitë e kandidatit në raport me kandidatin tjetër.

Faleminderit!

Marçela Shehu: Besoj që kjo ishte e qartë.

Por më duket se shqetësimi i Brikenës ishte tjetër. Mbase është momenti që të saktësojmë në preambulë 57-ën për të thënë që në raste të tjera të ngjashme Këshilli ka mbajtur këtë standard, që komandimi duhet të përfundojë plotësisht që të quhet vlerë e shtuar. Në rastin konkret, zonja {...} nuk e ka përfunduar, prandaj nuk konsiderohet. Këtë e thotë ligji.

Klodian Kurushi: Këtë kemi thënë edhe ne.

Marçela Shehu: Po pra, është thënë në relacion.

Tani, diskutimi: A ka vend ta themi në preambulë?

Naureda Llagami: Po e hedhim në votim, me gjithë nenin 57, pika 3, sugjerim për t'u përfshirë tek preambula. Jemi dakord me projekt-aktin?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Dakord.

Dritan Hallunaj: Kundër për nenin 57, pika 3. Për pjesën tjetër jam dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Kundër propozimit për shtesën në preambulë. (*Vota e zotit Toro nuk është bërë e mundur të dëgjohet në audio, por për efekt të procesverbalit, gjatë zbardhjes së tij, i vënë në dijeni për faktin, e ka shprehur atë nëpërmjet e-mailit. E-maili me konfirmimin e votës së tij i bashkëlidhet procesverbalit të sigluar.*)

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Kundër propozimit të fundit.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Miratimin e renditjes së kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 119, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:

1. Z. {...};

2. Znj. {...}.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit iu njoftohet kandidatëve z. {...} dhe znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

3. Kundër vendimit mund të bëhet ankim nga çdo kandidat, në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit.

Ky vendim botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 19.09.2022)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimeve “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 117/118, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:48 dhe mbaroi në orën 13:57.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Irena Plaku*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtare)
10. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashë.*
- 2. Denisa Varfi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 3. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 4. Përfaqësues nga Universiteti “Epoka”.*
- 5. Staf administrativ i KLGJ-së; Media KLGJ.*
- 6. Valbona Bala, USAID.*
- 7. Edmond Hoxhaj.*

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimeve “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 117/118, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Naureda Llagami: Kalojmë në projekt-aktin e radhës që ka të bëjë edhe ky me renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 117, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Për më shumë detaje, fjalën ia jap sërish zotit Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit Kryetare!

Meqenëse relacioni që unë tani do ta prezantoj ka një përmbajtje thuajse të njëjtë me relacionin që unë përmenda më lart, do propozoja të kalojmë nëse janë dakord të gjithë kolegët, vetëm në projektvendimet përkatëse që ne kemi bërë, sepse në të dyja rastet na rezultojnë që kandidatja e vetme është zonja {...}, kështu që nuk kemi probleme me renditjen pasi është një kandidate e vetme.

Nëse jeni dakord të gjithë kolegët, unë mund të kaloj drejtpërdrejt në projektvendimet. Janë dy projektvendime që i korrespondojnë dy pozicioneve të hapura nga Këshilli.

Naureda Llagami: Atëherë, bëhet fjalë për dy projekt-akte, një ka të bëjë me vendimin nr. 117, datë 01.04.2021 dhe vendimi tjetër është vendimi nr. 118, datë 01.04.2021.

Hedhim në votim projekt-aktin e parë që i përket vendimit nr. 117, pozicioni i hapur më datë 01.04.2021. Jeni dakord?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Miratimin e renditjes së kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 117, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:

1. Znj. {...}.
2. Një kopje e arsytuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.
3. Kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit.

Vendimi botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Naureda Llagami: Kalojmë në projekt-aktin e radhës i cili është i njëjtë, por bëhet fjalë për pozicionin e hapur me nr. 118, ku kandidatet e vetme është sërish zonja {...}. Jeni dakord?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord. (*Vota e zotit Toro nuk është bërë e mundur të dëgjohet në audio, por për efekt të procesverbalit, gjatë zbardhjes së tij, i vënë në dijeni për faktin, e ka shprehur atë nëpërmjet e-mailit. E-maili me konfirmimin e votës së tij i bashkëlidhet procesverbalit të sigluar.*)

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Edhe në këtë rast, Këshilli vendosi:

1. Miratimin e renditjes së kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 118, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:

1. Znj. {...}.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatës znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

3. Kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit.

Ky vendim botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 19.09.2022)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Korçë, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 132, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Marçela Shehu).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:48 dhe mbaroi në orën 13:57.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Irena Plaku*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtare)
10. ***Marçela Shehu*** (anëtare)
11. ***Yllka Rupa*** (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
2. *Denisa Varfi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
3. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
4. *Përfaqësues nga Universiteti “Epoka”.*
5. *Staf administrativ i KLGJ-së; Media KLGJ.*
6. *Valbona Bala, USAID.*
7. *Edmond Hoxhaj.*

RENDI I DITËS:

4. Shqyrtimi i projektvendimit “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Korçë, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 132, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Marçela Shehu).

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti tjetër që ka të bëjë me renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Korçë, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 132, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Për më shumë detaje fjalën ia jap zonjës Shehu.

Marçela Shehu: Faleminderit!

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në kuadër të plotësimit të pozicioneve të lira në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, ndër të tjera, ka hapur një procedurë ngritjeje në detyrë edhe në Gjykatën e Apelit Korçë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, shpallur me vendimin e tij nr. 132, datë 01.04.2021.

Lidhur me këtë pozicion ka kandiduar konkretisht kandidati z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, aktualisht i caktuar në skemën e delegimit me vendimin nr. 414, datë 29.09.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, deri më 14.10.2022.

Zoti {...} ka kandiduar edhe për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 129, datë 01.04.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në fushën e së drejtës penale, por më

pas ai ka rikonsideruar aplikimet e tij duke u tërhequr nga kandidimi, pikërisht pra për këtë pozicion të shpallur me vendimin nr. 129.

Lidhur me këtë kërkesë të paraqitur nga kandidati, Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendimin nr. 354, datë 27.07.2022 ka vendosur: Përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale të shpallur me Vendimin nr. 129, datë 01.04.2021, të Këshillit, për kandidatin z. {...}, për shkak të tërheqjes së tij nga kandidimi për këtë pozicion.

Sipas pikës 9, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 Këshilli bën renditjen e kandidatëve që përmbushin kriteret, renditje kjo që bëhet në funksion të përzgjedhjes së kandidatit të renditur më lart, i cili do të duhet të ngrihet në detyrë në atë pozicion të lirë.

Për të evidentuar kandidatët që përmbushnin kriteret e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Korçë, Këshilli realizoi procedurën e verifikimit të plotësimit, në rastin konkret për të vetmin kandidat, të kriterëve të mëposhtme:

- 1) “përvojës profesionale minimale”;
- 2) “mospasjes masë disiplinore në fuqi”;
- 3) “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”;
- 4) “të pasurisë dhe figurës”.

Në përfundim, Këshilli vendosi me vendimin nr. 353, datë 09.09.2021 kualifikimin e këtij kandidati, pasi rezultoi se plotësonte të gjitha kriteret e cituara më sipër dhe vijimin e procedurës për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Korçë, për pozicionin e lirë ku ka kandiduar.

Gjithashtu, përveç procedurës së verifikimit të kriterëve të kandidimit, paralelisht, për kandidatin kanë përfunduar tashmë edhe procedurat vlerësimit etik dhe profesional, konkretisht:

1) vlerësimi me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016 dhe 2) vlerësimi i përshpejtuar për vitin 2019. Për të dy këto periudha vlerësimi, kandidati është vlerësuar në nivelin e përgjithshëm "Shkëlqyeshëm".

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të administruar, në kushtet kur në këtë procedurë ngritjeje në detyrë ka kandiduar vetëm një kandidat dhe për rrjedhojë edhe në procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve është vetëm një i tillë, u vlerësua se nuk ka vend për ndjekjen e hapave, kriterëve dhe përparësive sipas përcaktimeve të Kreut IV, të vendimit 70/2020 në funksion të renditjes së kandidatëve.

Nga ana tjetër, në respektim të përcaktimeve të Seksionit B, Kreu VI, të Vendimit 70/2020, është përgatitur projektvendimi “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Korçë, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 132, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Projektvendimi është i strukturuar në 3 pika.

Sipas pikës 1 të projektvendimit, Këshillit i propozohet të miratojë renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Korçë, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 132, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë: 1) Z. {...}.

Në pikën 2 të projektvendimit, përcaktohet se një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit Z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016.

Në pikën 3 të projektvendimit përcaktohet se kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit.

Ky është edhe projektvendimi i përgatitur dhe i miratuar nga mbledhja e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

Naureda Llagami: Faleminderit zonja Shehu!

Ftoj kolegët, nëse s’kanë diskutime, në miratimin e projekt-aktit, sipas propozimit të ardhur.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord. (*Vota e zotit Toro nuk është bërë e mundur të dëgjohet në audio, por për efekt të procesverbalit, gjatë zbardhjes së tij, i vënë në dijeni për faktin, e ka shprehur atë nëpërmjet e-mailit. E-maili me konfirmimin e votës së tij i bashkëlidhet procesverbalit të sigluar.*)

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Miratimin e renditjes së kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Korçë, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 132, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:

1. Z. {...}.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

3. Kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit.

Ky vendim botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 19.09.2022)

Pika 5 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit:

5.1 Për kualifikimin për emërim dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor të z. {...}, për pozicionin e këshilltarit ligjor pranë Gjykatës së Lartë.

5.2 Për kualifikimin për emërim dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor të z. {...}, për pozicionin e këshilltarit ligjor pranë Gjykatës së Lartë.

5.3 Për kualifikimin për emërim dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor të z. {...}, për pozicionin e këshilltarit ligjor pranë Gjykatës së Lartë.

5.4 Për kualifikimin për emërim në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...}, për pozicionin e ndihmësit ligjor pranë Gjykatave të Apelit.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:48 dhe mbaroi në orën 13:57.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami*** (kryetare)
- 2. Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
- 3. Klodian Kurushi*** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli*** (anëtare)
- 5. Irena Plaku*** (anëtare)

6. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
7. *Ridvan Hado* (anëtar)
8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
10. *Marçela Shehu* (anëtare)
11. *Yllka Rupa* (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
2. *Denisa Varfi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
3. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
4. *Përfaqësues nga Universiteti “Epoka”.*
5. *Staf administrativ i KLGJ-së; Media KLGJ.*
6. *Valbona Bala, USAID.*
7. *Edmond Hoxhaj.*

RENDI I DITËS:

5. Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit:

5.1 Për kualifikimin për emërim dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor të z. {...}, për pozicionin e këshilltarit ligjor pranë Gjykatës së Lartë.

5.2 Për kualifikimin për emërim dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor të z. {...}, për pozicionin e këshilltarit ligjor pranë Gjykatës së Lartë.

5.3 Për kualifikimin për emërim dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor të z. {...}, për pozicionin e këshilltarit ligjor pranë Gjykatës së Lartë.

5.4 Për kualifikimin për emërim në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...}, për pozicionin e ndihmësit ligjor pranë Gjykatave të Apelit.

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-aktet e tjera. Bëhet fjalë për katër projekt-akte të tjera të cilat kanë të bëjnë me kualifikimin për emërim të një ndihmësi ligjor dhe të tre këshilltarëve ligjorë, që do të relatohen nga zonja Luli.

Fatmira Luli: Këshilli i Lartë Gjyqësor, me disa vendimmarrje të tij, mbështetur në nenin 53, të ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe në vendimin nr. 217, datë 26.05.2021, “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve për në Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, profili këshilltar ligjor dhe ndihmës ligjor për vitin akademik 2021-2022” si dhe në vendimin e tij nr. 424, datë 12.10.2020, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ose për ndihmës ligjor”, si dhe mbasi ka konsideruar gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e pasurisë dhe figurës, ka vendosur për 4 kandidatët fitues si më poshtë:

- Me vendimin nr. 544, datë 23.11.2021 ka vendosur kualifikimin e kandidatës fituese znj. {...} dhe lejimin e saj për ndjekjen e Programit të Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës, viti akademik 2021 – 2022, profili ndihmës ligjor;

- Me vendimin nr. 568, datë 07.12.2021 ka vendosur kualifikimin e kandidatit fitues z. {...} dhe lejimin e tij për ndjekjen e Programit të Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës, viti akademik 2021 – 2022, profili këshilltar ligjor;

- Me vendimin nr. 64, datë 23.02.2022 ka vendosur kualifikimin e kandidatit fitues z. {...} dhe lejimin e tij për ndjekjen e Programit të Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës, viti akademik 2021 – 2022, profili këshilltar ligjor;

- Me vendimin nr. 65, datë 23.02.2022 ka vendosur kualifikimin e kandidatit fitues z. {...} dhe lejimin e tij për ndjekjen e Programit të Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës, viti akademik 2021 – 2022, profili këshilltar ligjor.

Të gjithë kandidatët e mësipërm kanë përfunduar me sukses programin e formimit fillestar për këshilltar/ndihmës ligjor në vitin akademik 2021-2022.

Në kreun VII, të vendimit nr. 424, datë 12.10.2020 të KLGJ-së, titulluar “Procedura e verifikimit të kandidatëve për në shërbimin civil gjyqësor” ndarë në 5 pika, ku në dy prej tyre, konkretisht pikat 93 dhe 97 rregullohet mënyra sesi bëhet verifikimi për në shërbimin civil gjyqësor i kandidatëve që kanë përfunduar programin respektiv të formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, duke iu nënshtruar verifikimit të kushtit formal të pranimit në shërbimin civil gjyqësor.

Në këto dispozita të vendimit nr. 424/2020, Këshilli ka përcaktuar se për kandidatët të cilët kanë ndjekur programin e formimit fillestar, do të pranohen në shërbimin civil nëse plotësojnë kushtin e kalimit me sukses të këtij programi në Shkollën e Magjistraturës.

Me shkresën nr. {...} prot., datë 27.07.2022, Shkolla e Magjistraturës ka përcjellë vendimin e saj me nr. 26, datë 27.07.2022, “Për vlerësimin përfundimtar të kandidatëve për këshilltarë e ndihmës ligjor në Programin e Formimit Fillestar”, duke vendosur miratimin e listës së kandidatëve fitues, duke i renditur sipas pikëve që ata kanë marrë në vlerësimin përfundimtar në Programin e Formimit Fillestar.

Konform dispozitave të vendimit nr. 424/2020, Këshilli ka përcaktuar se jo më vonë se dy javë nga dërgimi prej Shkollës së Magjistraturës të listës së kandidatët që kanë përfunduar programin e formimit fillestar për këshilltar/ndihmës ligjor në Shkollën e Magjistraturës, disponohet në lidhje me kualifikimin dhe vijimin e procedurës së emërimit së tyre.

Ndërsa për këshilltarët ligjorë, akti përmban edhe kualifikimin edhe emërimin e tyre sepse vendi i tyre është në Gjykatën e Lartë. Për ndihmësit ligjorë, meqenëse dispozita ligjore dhe rregullorja parashikon që vendet më parë duhen shpallur dhe emërimi bëhet sipas renditjes, për ndihmëse {...}, pranimi në shërbimin civil do të bëhet pas renditjes dhe pas shpalljes së vendeve vakante.

Për këtë shkak, projekt-akti i pranimit dhe i kualifikimit për tre këshilltarët përmban tre pika.

Në pikën 1 të projektvendimit parashikohet kualifikimi për emërimin në shërbimin civil gjyqësor i secilit prej kandidatëve në pozicionin e këshilltarit/ndihmësit ligjor.

Në pikën 2 parashikohet pranimi në shërbimin civil gjyqësor vetëm për 3 kandidatët për pozicionin e këshilltarit ligjor.

Në pikën 3 parashikohen efektet e juridike të këtij vendimi, përfshirë edhe ato financiare, të cilat fillojnë me hyrjen në fuqi të vendimit.

Në fund parashikohet se hyrja në fuqi e aktit bëhet menjëhershme dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit zonja Luli!

Fillojmë sipas renditjes që kemi edhe materialet, me projekt-aktin e parë i cili ka të bëjë me kualifikimin për emërim në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...}, për pozicionin e ndihmësit ligjor në njësitë e shërbimit ligjor pranë gjykatave të apelit.

Jemi dakord?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord. (*Vota e zotit Toro nuk është bërë e mundur të dëgjohet në audio, por për efekt të procesverbalit, gjatë zbardhjes së tij, i vënë në dijeni për faktin, e ka shprehur atë nëpërmjet e-mailit. E-maili me konfirmimin e votës së tij i bashkëlidhet procesverbalit të sigluar.*)

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Kualifikimin për emërimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...}, në pozicionin e ndihmësit ligjor në njësitë e shërbimit ligjor pranë gjykatave të apelit.

2. Një kopje e vendimit i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti tjetër që ka të bëjë me kualifikimin për emërim dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor të z. {...}, për pozicionin e këshilltarit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë.

Jemi dakord?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord. (*Vota e zotit Toro nuk është bërë e mundur të dëgjohet në audio, por për efekt të procesverbalit, gjatë zbardhjes së tij, i vënë në dijeni për faktin, e ka shprehur atë nëpërmjet e-mailit. E-maili me konfirmimin e votës së tij i bashkëlidhet procesverbalit të sigluar.*)

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Kualifikimin për emërimin në shërbimin civil gjyqësor të z. {...}, në pozicionin e këshilltarit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë.

2. Pranimin në shërbimin civil gjyqësor të z. {...}, në pozicionin e këshilltarit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë.

3. Efektet juridike të këtij vendimi, përfshirë dhe ato financiare, fillojnë me hyrjen në fuqi të këtij vendimi.

4. Një kopje e vendimit i njoftohet z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit... .

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti i radhës që ka të bëjë me kualifikimin për emërim dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor të z. {...}, për pozicionin e këshilltarit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë.

Jemi dakord me projekt-aktin?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord. (*Vota e zotit Toro nuk është bërë e mundur të dëgjohet në audio, por për efekt të procesverbalit, gjatë zbardhjes së tij, i vënë në dijeni për faktin, e ka shprehur atë nëpërmjet e-mailit. E-maili me konfirmimin e votës së tij i bashkëlidhet procesverbalit të sigluar.*)

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Kualifikimin për emërimin në shërbimin civil gjyqësor të z. {...}, në pozicionin e këshilltarit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë.

2. Pranimin në shërbimin civil gjyqësor të z. {...}, në pozicionin e këshilltarit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë.

3. Efektet juridike të këtij vendimi, përfshirë dhe ato financiare, fillojnë me hyrjen në fuqi të këtij vendimi.

4. Një kopje e vendimit i njoftohet z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Naureda Llagami: Kalojmë tek vendimi i fundit që ka të bëjë me kualifikimin për emërim dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor të z. {...}, për pozicionin e këshilltarit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë.

Jemi dakord?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Kualifikimin për emërimin në shërbimin civil gjyqësor të z. {...}, në pozicionin e këshilltarit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë.

2. Pranimin në shërbimin civil gjyqësor të z. {...}, në pozicionin e këshilltarit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë.

3. Efektet juridike të këtij vendimi, përfshirë dhe ato financiare, fillojnë me hyrjen në fuqi të këtij vendimi.

4. Një kopje e vendimit i njoftohet z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

* * *

(Pika 5 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 19.09.2022)

Pika 6 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për transferimin e selisë së Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, në selinë e Gjykatës së Apelit Durrës”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:48 dhe mbaroi në orën 13:57.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 3. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 4. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 5. Irena Plaku | (anëtare) |
| 6. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 7. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 8. Alban Toro | (anëtar) |
| 9. Brikena Ukperaj | (anëtare) |
| 10. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 11. Yllka Rupa | (anëtare) |

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 2. Denisa Varfi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 3. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 4. Përfaqësues nga Universiteti “Epoka”.*
- 5. Staf administrativ i KLGJ-së; Media KLGJ.*
- 6. Valbona Bala, USAID.*
- 7. Edmond Hoxhaj.*

RENDI I DITËS:

6. Shqyrtimi i projektvendimit “Për transferimin e selisë së Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, në selinë e Gjykatës së Apelit Durrës”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Naureda Llagami: Kalojmë në projekt-aktin e radhës që ka të bëjë me transferimin e selisë së Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, në selinë e Gjykatës së Apelit Durrës.

Arsyeja e propozimit të këtij akti, nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, ka të bëjë me kërkesën e paraqitur nga Autoriteti Portual e cila i është përcjellë Gjykatës së Shkallës së Parë Administrative Durrës lidhur me lirim dhe dorëzimin e ambienteve për sa kohë godina në të cilën ndodhet kjo gjykatë, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave, do të jetë pjesë e inventarit të godinave që i përkasin projektit investues strategjik “Marina dhe jahtet e Durrësit” dhe është ndryshuar përgjegjësia e administrimit nga Autoriteti Portual tek Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Në këtë eventualitet, pasi zhvilluam edhe disa takime me të dy kryetarët e gjykatave respektive, ajo që u vlerësua nga Komisioni ishte që Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës të kalonte tek Gjykata e Apelit Durrës, duke marrë parasysh së pari që ajo gjykatë ka më shumë ambiente dhe numri i gjyqtarëve në atë gjykatë është më i vogël (aktualisht janë 5 (pesë), por në eventualitetin që zoti Kalaja do të caktohet në Gjykatën e Posaçme, janë 4 (katër)), ka më shumë salla, që lejohet që të punohet më

mirë nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë Administrative dhe ajo që është e rëndësishme është që duhet që më 1 shkurt, sipas zbatimit të hartës, kjo godinë do të mundësojë që të punojnë akoma edhe më mirë, derisa të bëhet edhe përthithja për gjykatat administrative.

Në fakt ne kemi propozuar, duke qenë se Autoriteti Portual ka lënë një afat të caktuar, datën 5 tetor, megjithatë mund të jemi fleksibël. Unë personalisht kam takuar të dy kryetarët e gjykatave të cilët në një farë mënyre kanë dakordësuar lidhur me mënyrën se si do të veprojnë, kanë ndarë edhe hapësirat bashkë se ku do veprojnë, duke i krijuar mundësinë që Gjykata e Shkallës së Parë Administrative të ketë sportelin e saj të shërbimeve, të ketë gjithë aksesin, gjithashtu edhe pjesën e infrastrukturës së teknologjisë ku ka filluar marrja e masave për të bërë të mundur bërjen sa më shpejt efiçente në ambientet e Gjykatës së Apelit Durrës.

Ky është shkaku dhe arsyet e propozimit të këtij projekt-akti.

Nëse keni ndonjë pyetje.

Unë në fakt do të propozoja që datën ta shtyjmë pak më vonë, duke qenë se vetë ma kërkuan jo nga data 5 (në fakt e thanë një herë nga data 5 dhe pastaj thanë ta bëjmë nga data 15). Kështu që do të propozoja datën 15 tetor.

Nëse nuk kemi ndonjë gjë, kalojmë në votimin e projekt-aktit?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Së bashku me sugjerimet e dhëna, atëherë, Këshilli vendosi:

1. Transferimin e Selisë së Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës në

selinë e Gjykatës së Apelit Durrës me adresë Rr. “Bajram Tusha”, lagjja nr. 14, Shkozet Durrës.

2. Fillimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, pranë selisë së re në datë 15.10.2022.

3. Ngarkohen Kryetarët dhe Këshillat e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës dhe Gjykatës së Apelit Durrës, të marrin masa për krijimin e kushteve të duhura në zbatim të pikës 1 dhe 2 të këtij vendimi.

4. Zëvendëskryetari i gjykatës, në zbatim të pikës 2 të këtij vendimi të marrë masat për të garantuar aksesin në gjykatë duke informuar publikun për transferimin e selisë së Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 6 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 19.09.2022)

Pika 7 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për një ndryshim në Vendimin nr.503 datë 25.10.2021 “Mbi transferimin e automjeteve të reja dhe atyre në përdorim, në sistemin gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.¹

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:48 dhe mbaroi në orën 13:57.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 3. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 4. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 5. Irena Plaku | (anëtare) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |
| 8. Brikena Ukperaj | (anëtare) |
| 9. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 10. Yllka Rupa | (anëtare) |

¹ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e teta sipas rendit të ditës.

Shënim: *Zoti Dritan Hallunaj* largohet nga mbledhja plenare dhe nuk merr më pjesë në trajtimin e çështjeve në vijim.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 2. Xhevdet Haxhiu, Drejtor i Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.**
- 3. Denisa Varfi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.**
- 4. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.**
- 5. Përfaqësues nga Universiteti “Epoka”.**
- 6. Staf administrativ i KLGJ-së; Media KLGJ.**
- 7. Valbona Bala, USAID.**
- 8. Edmond Hoxhaj.**

RENDI I DITËS:

7. Shqyrtimi i projektvendimit “Për një ndryshim në vendimin nr.503, datë 25.10.2021 “Mbi transferimin e automjeteve të reja dhe atyre në përdorim, në sistemin gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Naureda Llagami: Kemi tre projekt-akte rresht që kanë të bëjnë me pjesën e buxhetit. Kam ftuar këtu drejtorin i cili do t’i shpjegojë shkurtimisht.

Kalojmë në projektvendimin që ka të bëjë me një ndryshim në vendimin nr.503, datë 25.10.2021 “Mbi transferimin e automjeteve të reja dhe atyre në përdorim, në sistemin gjyqësor”. Për më shumë detaje fjalën ia jap drejtorit të buxhetit, z. Haxhiu.

Xhevdet Haxhiu: Faleminderit Kryetare!

Të nderuar anëtarë, me vendimin nr. 503 datë 25.10.2021, ka vendosur që të transferojë pa pagesë dy automjete të përdorura, nga Gjykata e Lartë për në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë dhe në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër.

Nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, kanë përfunduar procedurat e marrjes në dorëzim të automjetit nga Gjykata e Lartë. Ndërsa gjykata administrative nuk ka pranuar marrjen në dorëzim të këtij automjeti.

Struktura përgjegjëse ka komunikuar me Gjykatën e Lartë, e cila në janar 2022 është njoftuar për mos mbylljen e kësaj procedure transferimi pa pagesë të këtij automjeti. Aktualisht automjeti në fjalë është në inventar të Gjykatës së Lartë dhe sipas informacioneve të marra është në gjendje pune dhe si e tillë mund të transferohet brenda sistemit gjyqësor sipas nevojave.

Gjatë kësaj periudhe, ka paraqitur kërkesë (bile në momentin që u shqyrtua në Komision kishte sjellë edhe një kërkesë por e solli në Komision edhe një kërkesë tjetër) Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës.

Për sa më sipër, bazuar në legjislacionin në fuqi për menaxhimin e aktiveve në institucionet publike, propozojmë që automjeti tip Mercedes, i cili ishte vendosur për t'u transferuar tek Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë, të kalojë pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Atëherë, jemi dakord?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord. (*Vota e zotit Toro nuk është bërë e mundur të dëgjohet në audio, por për efekt të procesverbalit, gjatë zbardhjes së tij, i vënë në dijeni për faktin, e ka shprehur atë nëpërmjet e-mailit. E-maili me konfirmimin e votës së tij i bashkëlidhet procesverbalit të sigluar.*)

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Thjesht për informacion, zoti Hallunaj është larguar për shkak të një angazhimi profesional. Kështu që tek ky votim nuk do të jetë.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Ndryshimin e pikës 2 të vendimit nr. 503, datë 25.10.2021, si vijon, Transferimin e 1 (një) automjeti në përdorim nga Gjykata e Lartë, në Gjykatën Administrative Shkalla e Parë Durrës.

2. Me zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 7 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 19.09.2022)

Pika 8 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për rishpërndarjen (transferimin) e fondeve buxhetore në programin 03310 buxheti gjyqësor, në shpenzime kapitale (investime), për vitin buxhetor 2022”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.²

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:48 dhe mbaroi në orën 13:57.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami** (kryetare)
- 2. Ilir Rusi** (zëvendëskryetar)
- 3. Klodian Kurushi** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli** (anëtare)
- 5. Irena Plaku** (anëtare)
- 6. Ridvan Hado** (anëtar)
- 7. Alban Toro** (anëtar)
- 8. Brikena Ukperaj** (anëtare)
- 9. Marçela Shehu** (anëtare)
- 10. Yllka Rupa** (anëtare)

² Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e nënta sipas rendit të ditës.

Shënim: Zoti Dritan Hallunaj nuk merr pjesë në trajtimin e çështjes.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 2. Xhevdet Haxhiu, Drejtor i Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.*
- 3. Denisa Varfi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 4. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 5. Përfaqësues nga Universiteti “Epoka”.*
- 6. Staf administrativ i KLGJ-së; Media KLGJ.*
- 7. Valbona Bala, USAID.*
- 8. Edmon Hoxhaj.*

RENDI I DITËS:

8. Shqyrtimi i projektvendimit “Për rishpërndarjen (transferimin) e fondeve buxhetore në programin 03310 buxheti gjyqësor, në shpenzime kapitale (investime), për vitin buxhetor 2022”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Naureda Llagami: Kalojmë në projekt-aktin tjetër. Edhe ky është projekt-akt i cili afekton pjesën e buxhetit dhe do të raportohet nga drejtori i buxhetit. Bëhet fjalë për rishpërndarjen (transferimin) e fondeve buxhetore në programin 03310 buxheti gjyqësor, në shpenzime kapitale (investime), për vitin buxhetor 2022.

Xhevdet Haxhiu: Faleminderit Kryetare!

Të nderuar anëtarë!

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 495, datë 21.07.2022 “Për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave”, KLGJ-ja, ka filluar menjëherë punën për riorganizimin e gjykatave, fillimisht me riorganizimin e gjykatave të apelit, siç është përcaktuar edhe në VKM-në përkatëse.

Realizimi i këtij riorganizimi, shoqërohet me nevoja për fonde buxhetore, si rezultat i së cilës duhet të shikohet mundësia për rishpërndarjen e fondeve të lira gjatë vitit buxhetor në vazhdim, sipas nevojave që rezultojnë.

Kështu, nga ana e Departamentit të Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit, është përgatitur një memo, ku janë argumentuar disa nga arsyet për nevoja për fonde në kuadër të riorganizimit të gjykatave, ku këto nevoja konsistojnë në dy projekte: në blerje pajisje, instalim dhe zhvillime të reja në sistemin ICMIS (që kryesisht është për të gjithë sistemin), por fillimisht do të bëhet për gjykatat e apeleve si dhe është përlllogaritur edhe një vlerë përafërsisht 51,680,000 lekë si dhe në si dhe në shërbimin e transferimit, instalimit dhe testimit, të sistemit të regjistrimit Audio RDA, nëpër gjykatat e të gjitha niveleve (edhe kjo fillimisht do bëhet për gjykatat e apelit).

Ndodhur në këtë situatë, duke qenë se gjykata e apelit me juridiksion të përgjithshëm do duhet të fillojë veprimtarinë e vet në datën 01.02.2023 dhe që kërkon një akomodim shumë më të madh gjyqtarësh dhe stafit administrativ, kjo gjykatë gjatë vitit buxhetor, për vitin 2023, ka paraqitur kërkesa për rikonstrukcion të ambienteve. Por, Këshilli, në vendimin e tij në qershor, kërkesën që kishte bërë për projektet për rehabilitimin e ambienteve pjesërisht, për projektin e saj e miratoi nga rishpërndarja e fondeve që bëme në muajin qershor. Kështu që, edhe fondin i cili ishte programuar për t'u realizuar në vitin 2023, duke bërë një analizë të fondeve buxhetore në shpenzime kapitale, vlerëson që vlera prej 23,800,000 lekë të alokohet brenda këtij viti buxhetor për nevojën e rikonstrukcionit të pjesshëm të ambienteve të godinës së Gjykatës së Apelit Tiranë.

Ndërsa për sa i përket shumës prej 2,2 për shërbimin e transferimit, instalimit dhe testimit, të sistemit të regjistrimit Audio nëpër gjykatat e të gjitha niveleve, kjo do të realizohet nga fondet e lira që kanë rezultuar në shpenzime operative në programin 01110 buxheti i veprimtarisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në lidhje me shpenzimet kapitale, siç jeni në dijeni, shpenzimet kapitale janë detajuar në fillim të vitit buxhetor 2022, ku një pjesë e tyre i janë shpërndarë gjykatave dhe një pjesë e tyre është administruar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Për sa më sipër, duke bërë një analizë të gjendjes buxhetore të realizimit të deritanishëm dhe realizimit të pritshëm, deri në fund të vitit buxhetor, ne jemi mbështetur në këto nënartikuj buxhetor:

“Studime, Projektme”, ku rezulton një fond i lirë në vlerën 29,000,000 lekë. Siç jeni në dijeni, ky fond ka qenë i programuar dhe detajuar për hartimin e Projektit të Zbatimit për godinën e re të Gjykatës së Lartë. Mosrealizimi ka ardhur për shkak se nuk është vënë në dispozicion sheshi i ndërtimit (truall), nga Bashkia e Tiranës, e cila ka në juridiksion territorin në Tiranë, edhe pas kërkesave të bëra nga KLGJ. Vënia në dispozicion i sheshit është hapi i parë dhe i domosdoshëm për fillimin e hartimit të Projektit të Zbatimit, për ndërtimin e godinës së re për Gjykatën e Lartë. Duke qenë se jemi në kushtet e afateve shumë të limituara të vitit buxhetor, propozojmë që ky fond të kalojë për pjesën e “Blerje pajisje, software, instalim dhe zhvillime të reja në sistemin ICMIS në kuadër të hartës së re gjyqësore”.

Po ashtu në nënartikullin “Blerje automjete” investimi është realizuar por është realizuar me një kursim prej 2,600 mijë lekë fond i lirë.

Janë blerë motoçikleta, edhe këtu është realizuar investimi dhe është me një kursim 168 mijë lekë.

Është realizuar projekti “Programi i Dixhitalizimit të arkivave”, dhe ky është me një kursim prej 1,600 mijë lekë.

Po ashtu edhe “Programi Disaster Recovery & Pajisje” është realizuar me një kursim prej 8,1 mijë lekë.

“Programi i Implementimit të regjistrimit elektronik kombëtar” është realizuar investimi dhe me një kursim prej 3,4 mijë lekë fond i lirë.

Në total, në këtë program rezultojnë fonde të lira të cilat vlerësojmë të rishpërndahen sipas nevojave të identifikuar nisur nga implementimi i hartës së re gjyqësore në shumën prej 44,991 mijë lekë. Shuma prej 21,191 mijë lekë vlerësojmë të kalojë për projektin “Blerje pajisje, software, instalim dhe zhvillime të reja në sistemin ICMIS” (*diferenca e kostuar nga ana e drejtorisë së IT-së do të financohet nga viti buxhetor 2023*). Kjo pjesë do përdoret vetëm thjesht për gjykatat e apelit për të cilat kemi një afat kohor shumë të ngushtë. Ndërsa shuma prej 23,800 mijë lekë vlerësojmë të kalojë për rikonstruksionin e pjesshëm të ambienteve të godinës ekzistuese, të Gjykatës Apelit Tiranë.

Për sa më sipër, bazuar në legjislacionin për menaxhimin buxhetor, Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, i propozon seancës plenare, shqyrtimin dhe miratimin e rishpërndarjes së fondeve buxhetore të lira, në shpenzime

kapitale (investime), programi 03310 “Buxheti Gjyqësor”, për vitin buxhetor 2022, sipas pasqyrës së më poshtme.

Ju faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë, keni ndonjë pyetje meqë kemi Xhodën këtu?

Nëse jo kalojmë në votimin e projekt-aktit.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Miratimin e rishpërndarjes (transferimit) së fondeve të lira në programin 03310 “Buxheti Gjyqësor”, në shpenzime kapitale (Investime), për vitin buxhetor 2022, sipas pasqyrës bashkëlidhur.

2. Me zbatimin e këtij Vendimi, ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 8 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 19.09.2022)

Pika 9 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për transferimin (rishpërndarjen) e fondeve buxhetore në programin 03310, në shpenzime korrente, për vitin buxhetor 2022”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.³

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:48 dhe mbaroi në orën 13:57.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 3. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 4. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 5. Irena Plaku | (anëtare) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |
| 8. Brikena Ukperaj | (anëtare) |
| 9. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 10. Yllka Rupa | (anëtare) |

³ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e shtata sipas rendit të ditës.

Shënim: Zoti Dritan Hallunaj nuk merr pjesë në trajtimin e çështjes.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 2. Xhevdet Haxhiu, Drejtor i Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.*
- 3. Denisa Varfi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 4. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 5. Përfaqësues nga Universiteti “Epoka”.*
- 6. Staf administrativ i KLGJ-së; Media KLGJ.*
- 7. Valbona Bala, USAID.*
- 8. Edmon Hoxhaj.*

RENDI I DITËS:

9. Shqyrtimi i projektvendimit “Për transferimin (rishpërndarjen) e fondeve buxhetore në programin 03310, në shpenzime korrente, për vitin buxhetor 2022”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Naureda Llagami: Kalojmë në projekt-aktin e radhës që ka të bëjë edhe kjo me rishpërndarjen, transferimin e fondeve buxhetore në programin 03310, në shpenzime korrente, për vitin buxhetor 2022. Prapë fjalën e ka zoti Haxhiu.

Xhevdet Haxhiu: Faleminderit Kryetare!

Të nderuar anëtarë të Këshillit!

Siç jeni në dijeni, Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendimin nr. 351, datë 27.07.2022 “Mbi zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga Kontrolli i Lartë i Shtetit”, ka vendosur se për të gjithë magjistratët dhe këshilltarët ligjorë jomagjistratë në Gjykatën e Lartë, pavarësisht nga pozicioni i tyre i punës (Kategoritë G1, G2 dhe G3), paga referuese bazë të përllogaritjet mbi bazën e plotë të pagës së Drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme në Kryeministri, e cila përbëhet nga paga e grupit plus shtesën e pagës (132,100 = 14,000

+ 118,100) dhe jo siç përlloraget aktualisht, vetëm mbi shtesën për pozicion (118,100).

Kjo pagesë do të bëhet duke filluar nga momenti i hyrjes në fuqi të ligjit nr. 96/2016 në 1 janar 2019 dhe deri në datën 28 maj 2021, datë në të cilën ka hyrë në fuqi ligji nr. 50/2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016”.

Në zbatim të këtij vendimi, nga struktura përgjegjëse për administrimin e buxhetit pranë KLGJ-së u realizuar një analizë e gjendjes së fondeve buxhetore, (realizimi i deritanishëm gusht 2022, dhe realizimi i pritshëm deri ne 31 dhjetor 2022), në programin 03310, në shpenzime korrente, për artikujt 600, 601 dhe 602, duke u mbështetur në:

-Informacionin e sjellë nga 38 gjykatat e të tre niveleve në lidhje me përlloraget e diferencës të pagës referuese;

- Evidentimin e fondet e lira në shpenzime korrente (600, 601 dhe 602), për çdo gjykatë, për këtë vit buxhetor;

- Evidentimin e efektit financiar të përlloragur për periudhën e sipërcituar për të gjitha gjykatat, i cili rezulton në total përafërsisht në vlerën 370 milion lekë.

Fonde të lira në programin 03310, në shpenzime korrente (600, 601 dhe 602), rezultojnë në vlerën 150,000 mijë lekë, vlerë e cila mbulon afërsisht 40% të totalit të efektit të përlloragur për të gjitha gjykatat. Pjesa tjetër e fondeve, është bërë pjesë e kërkesave buxhetore të cilat janë miratuar si në fazën e parë dhe në fazën e dytë PBA 2023-2025 dhe do të paguhen pas akordimit të fondeve nga Ministria e Financave për vitin buxhetor 2023.

Për sa më sipër, Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, pasi mori në shqyrtim dhe miratoi relacionin e përgatitur nga Departamenti i Administrimit dhe Programimit të Buxhetit, i propozon seancës plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor:

- shqyrtimin dhe miratimin e rishpërndarjes (transferimit) së fondeve të lira në programin 03310 “Buxheti Gjyqësor”, në shpenzime korrente (600, 601 dhe 602), për vitin buxhetor 2022, nga gjykatat tek 03310-KLGJ, sipas pasqyrës nr. 1, bashkëlidhur;

- shqyrtimin dhe miratimin e rishpërndarjes (transferimit) së fondeve programi 03310 “Buxheti Gjyqësor”, në shpenzime korrente (600, 601 dhe 602), për vitin buxhetor 2022, nga 03310-KLGJ, tek gjykatat e të gjitha niveleve, sipas pasqyrës nr. 2, bashkëlidhur.

Faleminderit për vëmendjen!

Naureda Llagami: Faleminderit për relatimin!
Atëherë, ftoj kolegët nëse nuk kanë ndonjë diskutim, të votojmë mbi projekt-aktin.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Miratimin e rishpërndarjes (transferimit) së fondeve të lira në programin 03310 “Buxheti Gjyqësor”, në shpenzime korrente (600, 601 dhe 602), për vitin buxhetor 2022, nga gjykatat tek 03310-KLGJ, sipas pasqyrës nr. 1, bashkëlidhur.

2. Miratimin e rishpërndarjes (transferimit) së fondeve në programin 03310 “Buxheti Gjyqësor”, në shpenzime korrente (600, 601 dhe 602), për vitin buxhetor 2022, nga 03310-KLGJ, tek gjykatat, sipas pasqyrës nr. 2, bashkëlidhur.

3. Me zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 9 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 19.09.2022)

Pika 10 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, (relator z.Alban Toro):

10.1 "Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit {...} në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës".

10.2 "Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit {...} në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë".

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:48 dhe mbaroi në orën 13:57.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Irena Plaku*** (anëtare)
6. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
7. ***Alban Toro*** (anëtar)
8. ***Brikena Ukperaj*** (anëtare)
9. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

Shënim: Zoti Dritan Hallunaj nuk merr pjesë në trajtimin e çështjes.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
2. *Denisa Varfi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
3. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
4. *Përfaqësues nga Universiteti "Epoka".*
5. *Staf administrativ i KLGJ-së; Media KLGJ.*
6. *Valbona Bala, USAID.*
7. *Edmond Hoxhaj.*

RENDI I DITËS:

10. Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, (relator z.Alban Toro):

10.1 "Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit {...} në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës".

10.2 "Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit {...} në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë".

Naureda Llagami: Kalojmë tek dy projekt-aktet që vijnë nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës që bëjnë fjalë për përsëritjen e transferimit të përkohshëm, një të gjyqtarit {...} në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës dhe tjetri për gjyqtarin {...} në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë.

Për më shumë detaje fjalën ia jap zotit Toro.

Alban Toro: Faleminderit!

Duke konsideruar Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës si gjykatë në nevojë, më herët me anë të vendimit nr.373, datë 13.09.2022 nga ana e Këshillit është hapur procedura e transferimit të përkohshëm dhe njëkohësisht i është drejtuar

gjqtarit aktualisht z. {...} i cili është ftuar për të dhënë pëlqimin për përsëritjen e transferimit të tij.

Më datë 14.09.2022 gjyqtari {...} ka shprehur pëlqimin për vijimin e transferimit, kështu që kemi vijuar konform nenit 46 të Ligjit nr.96/2016 dhe nenit 8 të vendimit nr. 23, 07.02.2019 dhe i kemi kërkuar opinion zëvendëskryetarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë në lidhje me:

- ngarkesën e gjykatës të cilën drejton në përgjithësi;
- pasojat që krijohen për gjykatën nga vazhdimi i transferimit të gjyqtarit pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës;
- si edhe një propozim mbi periudhën maksimale për të cilën gjyqtari kërkohet të transferohet duke marrë në konsideratë efektet negative të shkaktuara nga ky transferim.

Bashkëlidhur këtij relacioni ju kam dërguar edhe përgjigjen e zëvendëskryetarit dhe në mënyrë të sintetizuar zëvendëskryetari shprehet pozitiv në lidhje me përsëritjen e transferimit, ndërsa në lidhje me periudhën maksimale për të cilën gjyqtarit duhet t'i përsëritet transferimi ai e lidh me afatet të cilat ka parashikuar harta gjyqësore në lidhje me gjykatat në Republikën e Shqipërisë.

Kështu që, duke vlerësuar ngarkesën aktuale të gjyqtarit që ka shprehur pëlqimin pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, fusha e së drejtës (specifike) që mbulon në këtë gjykatë në nevojë, cenimin e funksionimit normal, marrë në konsideratë jo vetëm organiken aktuale por edhe numrin e madh të çështjeve, ekzistenca e pozicionit të lira të përkohshëm në të, ngarkesa aktuale Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë ku ai është caktuar në mënyrë të përhershme, përfundimi i afatit të transferimit të përcaktuar me vendim nr. 364, datë 14.09.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor; nga ana e Komisionit është propozuar projektvendimi i cili zgjidh problemet në fjalë, ku në dispozitivin e të cilit ju sugjerohet të miratoni:

Gjyqtari z. {...}, aktualisht gjyqtar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, i përsëritet transferimi i përkohshëm, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës, për periudhën deri më datë 01.06.2023, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

Efektet e këtij vendimi fillojnë nga data 20.09.2022.

Njoftimin e këtij vendimi gjyqtarit z. {...}, Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë, keni ndonjë diskutim? Nëse jo, kalojmë në votim?

Ilir Rusi: Meqenëse i referohemi vendimit të Këshillit të Ministrave mbi riorganizimin e rretheve gjyqësore, afati është 01.07 dhe jo 01.06.

(Pranohet propozimi i zotit Rusi mbi datën si dhe mbi heqjen e togfjalëshit në pikën e parë “nga hyrja në fuqi e këtij vendimi”). Vazhdon votimi.)

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro, me ndryshimet e propozuara nga zoti Rusi.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli (me gjithë ndryshimet) vendosi:

1. Gjyqtarit {...}, aktualisht gjyqtar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, i përsëritet transferimi i përkohshëm, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës, për periudhën deri më datë 01.07.2023.

2. Efektet e këtij Vendimi fillojnë nga data 20.09.2022.

3. Njoftimin e këtij vendimi gjyqtarit z. {...}, Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti tjetër që do të relatohet sërish nga zoti Toro.

Alban Toro: E njëjta situatë edhe për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë, e cila nga ana e Këshillit është konsideruar si gjykatë në nevojë për shkak të pozicioneve të përkohshme të lira.

Më herët, me vendimin nr. 372, datë 13.09.2022, nga ana e Këshillit është vendosur, hapja e procedurës së transferimit të përkohshëm për një pozicion të lirë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë, me një afat deri në datën 01.04.2023. Kjo shpallje i drejtohet gjyqtarit të transferuar aktualisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë, zotit {...}, i cili ftohet për të dhënë pëlqimin për përsëritjen e transferimit të përkohshëm.

Nga ana e gjyqtarit është dërguar me shkresën e datës 14.09.2022 pëlqimi për vijim e transferimit të përkohshëm. Kështu që në këto kushte i jemi drejtuar zëvendëskryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, konform nenit 46 të ligjit 96/2016 dhe nenit 8 të vendimit nr.23, date 07.02.2019, ku i kemi kërkuar opinion në lidhje me:

- ngarkesën e gjykatës të cilën ai drejton;
- pasojat që krijohen për gjykatën nga vazhdimi i transferimit;
- si edhe një propozim mbi periudhën maksimale për të cilën gjyqtari

kërkohet të transferohet.

Natyrisht edhe këtë shkresë, pra opinionin e zëvendëskryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor jua kam dërguar nëpërmjet e-mail-it. Gjithsesi, në mënyrë të sintetizuar, nga përmbajtja e tij, rezulton që ai nuk është dakord me vijimin e transferimit për shkak të burimeve të kufizuara të gjyqtarëve në këtë gjykatë si dhe tendencës për t'u rritur çështjet në muajt në vijim. Kështu që, në këto kushte, ai nuk shpreh dakordësinë në lidhje me këtë pjesë.

Gjithsesi, Komisioni, konform neneve 45 dhe 46, duke vlerësuar ngarkesën aktuale të gjyqtarit që ka shprehur pëlqimin pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, cenimin e funksionimit normal, marrë në konsideratë jo vetëm organiken aktuale por edhe numrin e madh të çështjeve, ekzistencën e pozicionit të lira të përkohshëm në të, ngarkesën aktuale Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec ku ai është caktuar në mënyrë

të përhershme, përfundimin e afatit të transferimit të përcaktuar me Vendim nr. 365 datë 14.09.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ju propozon që:

1. Gjyqtarit {...}, aktualisht gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, i përsëritet transferimi i përkohshëm, në Gjykatës e Rrethit Gjyqësor Kavajë, për një periudhë deri më datë 01.04.2023.

2. Efektet e këtij Vendimi fillojnë nga data 20.09.2022.

3. Njoftimin e këtij vendimi gjyqtarit z. {...}, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë, përveç një sugjerimi për 01.05. dhe jo 01.04, pjesa tjetër është okej, dhe të heqim të njëjtin togfjalësh.

Hedhim në votim projekt-aktin.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Gjyqtarit {...}, aktualisht gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, i përsëritet transferimi i përkohshëm, në Gjykatës e Rrethit Gjyqësor Kavajë, për një periudhë deri më datë 01.05.2023.

2. Efektet e këtij vendimi fillojnë nga data 20.09.2022.

3. Njoftimin e këtij vendimi gjyqtarit z. {...}, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 10 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 19.09.2022)

Pika 11 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional, me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimit), për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016, të gjyqtares {...}”, (relatore znj. Irena Plaku).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:48 dhe mbaroi në orën 13:57.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Irena Plaku*** (anëtare)
6. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
7. ***Alban Toro*** (anëtar)
8. ***Brikena Ukperaj*** (anëtare)
9. ***Marçela Shehu*** (anëtare)
10. ***Yllka Rupa*** (anëtare)

Shënim: Zoti Dritan Hallunaj nuk merr pjesë në trajtimin e çështjes.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
2. *Denisa Varfi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
3. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
4. *Përfaqësues nga Universiteti “Epoka”.*
5. *Staf administrativ i KLGJ-së; Media KLGJ.*
6. *Valbona Bala, USAID.*
7. *Edmond Hoxhaj.*

RENDI I DITËS:

11. Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional, me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimit), për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016, të gjyqtarës {...}”, (relatore znj. Irena Plaku).

Naureda Llagami: Atëherë, kalojmë me çështjen tjetër e cila ka të bëjë me vlerësimin e raportit etik dhe profesional për gjyqtaren {...}, me qëllim gradimi, për periudhën 2013-2016.

Pa humbur kohë fjalën ia jap zonjës Plaku.

Lutem në mënyrë të sintetizuar.

Irena Plaku: Faleminderit!

Po ju parashtoj vlerësimin e gjyqtarës {...}. Procedura e vlerësimit për këtë gjyqtare ka filluar me vendimin nr. 94, datë 09.03.2022, pas dërgimit të dosjeve me aktet e vlerësimit profesional nga organet e rivlerësimit kalimtar. Me këtë vendim, pas shortit të realizuar, është përzgjedhur vlerësuesi, unë si relatore dhe nëpunësi përgjegjës.

Me vendimin e datës 20.07.2022 është vlerësuar mbyllja e procedurës për sa i përket akteve të dosjes.

Vlerësimi për këtë gjyqtare bëhet sipas katër kriterëve.

Konkretisht, për sa i përket kriterit të aftësive profesionale, për nënkriterin “Njohuritë ligjore”, nga burimet e vlerësimit rezulton se aftësia e gjyqtares për paraqitjen dhe analizën e plotë të fakteve, si atyre me natyrë procedurale, në të cilat jep një panoramë të qartë të ecurisë së çështjes dhe veprimeve të kryera, së bashku me analizën ligjore në rastet kur elementët procedurale lidhen me trajtimin e kërkesave të palëve apo elementë procedurale të vlerësuar kryesisht nga gjykata, ashtu edhe të fakteve thelbësore të çështjes të cilat paraqiten në mënyrë të detajuar, të plotë dhe analitike, duke integruar provat e administruara në gjykim dhe faktin e ekstraktuar si pasojë e analizës dhe vlerësimit tërësor të tyre. Po ashtu rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të larta në identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjes, citimin dhe analizën e tyre në mënyrë të veçantë dhe të integruar me njëra-tjetrën, në funksion të përcaktimit të qartë të natyrës së mosmarrëveshjes në shqyrtim, e cila shërben si bazë për orientimin e arsyetimit dhe analizës ligjore lidhur me zgjidhjen e çështjes.

Për këtë nënkriter shkalla e aftësisë është propozuar si shumë e lartë, duke e vlerësuar me 20 pikë.

Sa i përket nënkriterit “Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes” - Në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, identifikimi i normës juridike, si ligj i zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, bëhet në shërbim të analizës juridike të fakteve objekt shqyrtimi dhe duke sjellë si rrjedhojë logjike konkluzionin e arritur nga gjyqtarja lidhur me zbatimin e saj. Normat ligjore citohen duke u shoqëruar në çdo rast me interpretimin e tyre dhe aplikimin mbi faktet e çështjes, si në ato me natyrë procedurale ashtu edhe në ato që kanë lidhje me themelin e çështjes. Tipar karakteristik i gjyqtares është se në çdo rast citimi ose referimi i dispozitave është shoqëruar me interpretimit të tyre në mënyrë të abstrakte dhe individuale, para aplikimit mbi faktin konkret ose konkluzionin e arritur. Interpretimi i dispozitave materiale/procedurale bëhet nga ana e gjyqtares sipas mënyrës së interpretimit të tyre, në funksion të analizës juridike dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Në lidhje me interpretimin e ligjit material të zbatueshëm:

(i) Në vendimet civile: Në të gjitha vendimet e analizuara interpretimi i normës juridike bëhet jo vetëm në aspektin abstrakt të saj, duke identifikuar në mënyrë specifike qëllimin, funksionin, apo duke përcaktuar kushtet dhe kriteret që duhet të

plotësohen në mënyrë kumulative që të gjejë zbatim pretendimi dhe kërkimi i palës, duke i renditur në çdo rast, por në përputhje me faktin dhe provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim.

(ii) Në vendimet penale: Në vendimet penale të analizuara, duke iu referuar natyrës së çështjes, e cila përcakton edhe elementët që duhet të analizohen në aspektin e provueshmërisë së faktit penal, gjyqtarja interpreton normën përkatëse të Kodit Penal në mënyrë abstrakte, duke dhënë kuptimin e saj dhe duke evidentuar dhe analizuar elementët e figurës së veprës penale konkrete, veçanërisht në çështjet penale të themelit, ku ky interpretim është i domosdoshëm. Interpreton dispozitat materiale në funksion të përcaktimit të cilësimit juridik të veprës penale dhe përgjegjësisë së autorit në kryerjen e saj. Kryesisht, konstatohet se gjyqtarja interpreton teorikisht normën relevante të Kodit Penal, duke bërë një përshkrim të përgjithshëm në lidhje me elementët dallues të veprës penale përkatëse që i atribuohet të pandehurit, dhe në vijim duke e përputhur me faktet dhe provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim, nxjerr konkluzionin në lidhje me përgjegjësinë penale të autorit.

(iii) Në të gjitha vendimet penale të analizuar analizohen në të katër elementët e figurës së veprës penale në çështjet e themelit. Në këto të fundit, gjyqtarja përqendrohet më tepër në elementë të anës objektive të veprave penale, me qëllim cilësimin e saktë juridik të faktit penal.

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit procedural dhe material, në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me çështjen. Evidentohet kujdesi i gjyqtarës për të identifikuar dhe zbatuar praktikën relevante gjyqësore unifikuese, praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë, të Gjykatës Kushtetuese dhe të GJEDNJ, si dhe kujdesi për të referuar dhe zbatuar parimet e së drejtës, si në aspektin procedural, ashtu edhe atë thelbësor, parime të cilat integrohen në arsyetim dhe mbështesin argumentet e saj lidhur me mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të ligjit, në funksion të konkluzioneve mbi zgjidhjen e çështjeve konkrete.

Për këtë nënkriter është propozuar pikëzimi i saj me 25 pikë.

Sa i përket nënkriterit “Arsyetimi ligjor”, “Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit” - Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues,

evidentohet se vendimet gjyqësore janë të qarta dhe të kuptueshme, duke u bërë të kuptueshëm edhe për një lexues të arsyeshëm, jo vetëm për njohësit e ligjit.

Në arsyetimin e vendimeve evidentohet zbatimi i saktë i rregullave gramatikore, të sintaksës në ndërtimin e fjalive, duke i dhënë qartësi përshkrimit të faktit, rrethanave procedurale dhe fakteve të çështjes, apo shprehjes së mendimit juridik. Rezulton se në të gjitha vendimet gjyqësore përdorimi i të gjitha shkronjave të alfabetit shqip.

Gjuha teknike përdoret në mënyrë korrekte dhe konsistente vetëm në rastet kur është i pashmangshëm përdorimi i saj.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në drejtim të treguesit të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit. Evidentohet një shkallë e lartë e gjyqtares në arsyetimin e ligjit si në aspektin abstrakt, duke e gërshetuar me praktikën unifikuese në funksion të analizës juridike, por edhe me faktet e provuara, gjithmonë duke i renditur në mënyrë logjike të gjitha shkaqet që çojnë në një vendimmarrje të caktuar.

Për këtë nënkriter është propozuar aftësia e gjyqtares si shumë e lartë dhe është propozuar pikëzimi me 15 pikë.

“Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit” - Gjyqtarja ndjek në hartimin e vendimit një strukturë të qëndrueshme dhe të organizuar të cilës i përmbahet, në prezantimin e fakteve me natyrë procedurale dhe fakteve thelbësore të çështjes, identifikimit të ligjit të zbatueshëm, por edhe lidhjes së tyre me konkluzionet e arritura, të cilat vijnë gjithnjë në përmbyllje procesit të arsyetimit ligjor dhe argumentimit logjik. Gjyqtarja ndjek metodologji të njëjtë të strukturimit të pjesëve përbërëse të vendimit, duke ndarë pjesën përshkruese-arsyetuese në nënndarje, të identifikuara me tituj, në funksion të orientimit mbi qëllimin e secilës pjesë. Vendimet gjyqësore burim vlerësimi përmbajnë pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese, si dhe dispozitivin.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në ndjekjen e një strukturë të qëndrueshme dhe të mirë organizuar të vendimit, e cila është e dukshme në aspektin vizual dhe të përmbajtjes, duke i dhënë qëndrueshmëri dhe kuptueshmëri vendimit.

Për këtë nënkriter është propozuar aftësia e gjyqtares shumë e lartë duke e pikëzuar me 10 pikë.

“Cilësia e analizës dhe argumentit logjik” - Referuar vendimeve objekt vlerësimi, evidentohet se në tërësi, në të gjitha aktet e analizuara rezultojnë një nivel shumë i mirë arsyetimi, gjithnjë i plotë dhe i qartë, duke shqyrtuar dhe argumentuar çdo element të diskutueshëm në raport me faktin civil apo penal, si dhe çdo element të vlerësuar të nevojshëm për t’u analizuar në raport me aspektet procedurale. Arsyetimi i vendimeve përfundimtare ndjek një zhvillim logjik të koncepteve ligjore të parashikuara në ligjin procedural dhe material, civil apo penal.

Evidentohet kujdesi i veçantë gjyqtarës në arsyetim, për të identifikuar dhe analizuar konceptet ligjore në dobi të konkluzioneve të arritura lidhur me zgjidhjen e çështjes. Gjyqtarja në çdo rast ka evidentuar në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme thelbin e konfliktit objekt gjykimi, duke orientuar edhe analizën e koncepteve ligjore, në shërbim të arritjes së konkluzioneve në lidhje me zgjidhjen e çështjes. Arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe përgjithësisht dhe merr në analizë dhe i jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërkimeve të palëve ndërgjyqëse, të cilat gjithashtu janë evidentuar në një pjesë të vendimit.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të lartë në treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik”.

Për këtë nënkriter është propozuar aftësia e gjyqtarës që duhet të vlerësohet shumë e lartë, duke e pikëzuar me 25 pikë.

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin e “Aftësive profesionale të gjyqtarës” propozohet "Shkëlqyeshëm", duke e pikëzuar me 100 pikë.

“Aftësitë organizative” – “Respektimi i afateve ligjore” – Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për të gjitha çështjet. Për këtë arsye janë marrë në analizë vetëm dosjet e përzgjedhura me short, tre vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja dhe 1 vendim për të cilin është referuar nga ILD-ja.

Vetëm njëra këto çështje ka rezultuar me afat ligjor dhe për këtë çështje nga ana e gjyqtarës është respektuar afati 48 orë dhe ka përfunduar brenda këtij afati të parashikuar në nenin 259, paragrafi 5 i K.Pr.Penale.

Për këtë arsye, duke qenë se nuk ka të dhëna për çështjet në gjykim për periudhën e vlerësimit, do të konsiderohet se gjyqtarja ka treguar kujdes të lartë në respektimin e afateve ligjore.

Kështu, për këtë kriter vlerësoj se në lidhje me treguesin “Respektimi i afateve ligjore” gjyqtarja duhet të pikëzohet me 15 pikë, pasi përqindja e çështjeve të shqyrtuara jashtë afatit ligjor rezulton në nivelin 0-10%.

“Plotësimi i standardeve minimale kohore” – Edhe për këtë nënkriter nuk ka të dhëna referuar statistikave të cilat janë dërguar nga gjykata përkatëse. Në këto kushte, vlerësimi do bëhet vetëm për çështjet të cilat janë të përzgjedhura me short, tre vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja, nga të cilat 10 rezultojnë që nuk parashikojnë afate ligjore dhe tre vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, nga 14 çështjet për të cilat zbatohen standardet minimale kohore, sikundër rezultoi edhe më sipër, rezultoi se jo të gjitha çështjet kanë përfunduar brenda standardit minimal kohor. Konkretisht ka rezultuar vetëm 21% e çështjeve janë jashtë afatit standard minimal kohor.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se standardi minimal kohor në fuqi është respektuar për 79% të çështjeve të analizuara. Kjo përqindje matematikore, sipas metodologjisë pikëzohet me 3 pikë. Por vlerësuesi duhet të marrë në analizë edhe kriteret e tjera.

Konkretisht janë marrë në analizë çështjet konkrete për të cilat ka kaluar standardi minimal i parashikuar:

Çështja që i përket vendimit civil nr.351, datë 13.04.2016 ka rezultuar se standardi minimal ka kaluar me 24 ditë. Por ka rezultuar se vështirësia e çështjes ka qenë e lartë pasur parasysh objektin e gjykimit “konstatimi i pavlefshmërisë absolute të kontratës së shitjes dhe detyrimi i njohjes pronar”. Ka rezultuar se gjatë gjykimit gjyqtarja ka marrë në shqyrtim kundërpadinë. Është paraqitur kërkesa për pakësimin e objektit të padisë, për të cilat ka qenë e nevojshme shtyrja e seancave me qëllim njoftimin e palëve.

Një çështje tjetër të cilës i ka kaluar afati prej dy muajsh është çështje administrative-penale ku ka rezultuar se çështja është gjykuar brenda 3 (tre) muajve e 22 ditë (jashtë afatit standard prej 2 muajsh). Rezulton se nuk ka të dhëna për sa i përket shkaqeve të shtyrjes së seancës por rezulton se çështja ka rënë për short në muajin

gusht dhe ka bërë të pamundur caktimin e saj në një afat të shkurtër. Duke zbritur periudhën e lejes, rezulton se afati të cilin ka tejkaluar është 30 ditë.

Ndërkohë, në lidhje me çështjen e trajtuar në relacionin e datës 22.10.2014 për të cilën është konkluduar se afati i gjykimit të çështjes civile t'i evidentohet gjyqtares për efekt të vlerësimit profesional dhe etik, kjo çështje nuk mund të konsiderohet në afat pasi pavarësisht faktit të shtyrjes të seancave. Ka rezultuar se kjo është çështje që i përket heqjes së zotësisë për të vepruar por vështirësia e çështjes ka rezultuar e lartë për shkak se vendimi... Domethënë përgjithësisht seancat janë shtyrë për arsye procedurale, si thirrja e personave të tretë në gjykim, shtyrje për formimin e trupit gjykues, për pyetjen në banesë të personit që kërkohet t'i hiqet zotësia juridike për të vepruar, ripyetja e tij në seanca, e cila është shtyrë dy herë për shkak të mosparaqitjes së tij duke u vendosur në dy raste shoqërimi i tij nga shërbimi i urgjencës, thirrjen e ekspertëve, përjashtimin e ekspertëve, për shkak se nuk janë paraqitur ekspertët e caktuar nga Ministria e Drejtësisë të cilët vinin nga Tirana.

Nga ana tjetër, në aspektin sasior të volumit të çështjeve të përfunduara, gjyqtarja ka përfunduar në total për 3 vite periudhë vlerësimi, konkretisht nga muaji shkurt 2014 - tetor 2016 (pra jo në 3 vite të plota), 1137 çështje, nga të cilat 209 çështje penale themeli, 350 çështje civile themeli, 101 çështje familjare, 3 çështje tregtare, etj.

Për sa më sipër, për pikëzimin e këtij treguesi, duke iu referuar analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit lidhur me:

(i) raportin e çështjeve të gjykuara tej standardit me numrin total të çështjeve të analizuar si më sipër cituar, që rezulton në masën 21%, e cila ka një diferencë prej 1% nga pikëzimi me 4 pikë.

(ii) faktorët që kanë ndikuar në kohëzgjatjen e gjykimit të cilat, nga dosjet e vëzhguara, nuk rezultojnë të jenë për shkaqe që janë përgjegjësi e gjyqtarit;

(iii) afatin e shkurtër të tejkalimit të këtij standardi minimal, e cila referuar afatit të gjykimit në dy çështje është më pak se 23 ditë dhe 30 ditë, dhe vetëm një çështje ka kaluar disa muaj, por edhe kjo varet nga natyrë e kësaj çështje, kryerja e veprimeve të domosdoshme procedurale, siç është marrja e provave me ekspert, me dëshmitar, pyetja dhe ripyetja e personit për të cilën është kërkuar heqja e zotësisë për të vepruar;

(iv) tejkalimin e standardit sasior të zbatueshëm mesatarisht me 72 çështje në vit;

vlerësoj se për këtë tregues gjyqtarja duhet të pikëzohet me një nivel më të lartë se ai që rezulton nga të dhënat statistikore, duke arritur në një pikëzim maksimal.

Sa më sipër, vlerësoj, se në lidhje me këtë tregues, gjyqtarja duhet të pikëzohet me 5 pikë, pasi shqyrtimi i 21% të çështjeve jashtë standardit minimal, ka ardhur përgjithësisht për shkaqe që nuk janë përgjegjësi e gjyqtares.

“Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje” – Referuar çështjeve të marra në analizë ka rezultuar se kohëzgjatja mesatare e çështjeve të vëzhguara, është më e shkurtër se standardi minimal kohor për shumicën e kategorive të çështjeve, tregues i cili, referuar Metodologjisë së Pikëzimit, pikëzohet me 4 pikë. Por duke marrë në konsideratë shkaqet e shtyrjes dhe të zgjatjeve të gjykimeve, të cilat kanë qenë kryesisht për shkaqe procedurale por edhe të mungesës së njoftimeve të palëve, afatin tepër të shkurtër të tejkallimit të afatit minimal prej 2 muajsh, çështjen ku ka kaluar më shumë afati, që është pikërisht heqja e zotësisë për të vepruar, për këtë është vlerësuar që të rritet vlerësimi me një pikëzim, duke e çuar maksimale.

“Rendimenti i përfundimit të çështjeve” – Referuar të dhënave statistikore ka rezultuar që në vitin 2014 i janë caktuar 441 çështje, ka përfunduar 390 çështje; Në vitin 2015, i janë caktuar 456 çështje, ka përfunduar 449 çështje; Në vitin 2016, i janë caktuar 449 çështje, ka përfunduar 423 çështje.

Megjithëse ka mungesë të dhënash për vitin 2013, tetor 2013 – tetor 2016 (pasi nuk janë të plota), është marrë e mirëqenë përqindja/rendimenti i nxjerrë nga raporti i KLGJ-së, konkretisht me 94%.

Nga të dhënat statistikore, rezulton se për periudhën e vlerësimit shkurt 2014-tetor 2016, gjyqtarja ka gjykuar 1137 çështje, nga të cilat 727 çështje themeli civile dhe penale, duke tejkalluar standardin minimal prej 200 çështjesh të parashikuar në vendimin e KLD-së nr. 261/2.

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, megjithëse rendimenti i gjyqtares për periudhën e vlerësimit rezulton në masën 94%, përqindje e cila referuar metodologjisë së Pikëzimit pikëzohet me 8 pikë, pasur parasysh faktin se gjyqtarja ka tejkalluar në çdo vit standardin minimal të miratuar, ku për vitin 2015 (i cili është vit i plotë i vlerësimit) e ka tejkalluar me 54%, tendencë e cila vërehet edhe për vitin 2016, faktin se megjithëse nuk ka gjykuar në një periudhë të plotë ajo e ka tejkalluar standardin minimal për tre vite me mesatarisht 72 çështje themeli më shumë, numrin e lartë të kërkesave penale e civile të

shqyrtuara gjatë periudhës së vlerësimit prej 413 kërkesa, të cilat rrisin dukshëm ngarkesën e gjyqtarit (pasur parasysh se kanë qenë edhe me afat ligjor), faktin se në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Beratit ka tre salla gjykimi dhe aty kanë ushtruar detyrën e gjyqtarit 10 gjyqtarë, çka e ka bërë të vështirë menaxhimin e kohës së gjykimit, vlerësoj se për këtë kriter duhet të pikëzohet me 10 pikë.

Për sa i përket “Kohës mesatare e arsytimit të vendimit”, duke iu referuar burimeve të vlerësimit, koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar rezulton “Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve”. Konkretisht, për çështjet penale ka rezultuar 3.5 ditë, për çështjet civile themeli 7.75 ditë dhe për çështjet familjare 4.5 ditë.

Për këtë nënkriter është vlerësuar, duke qenë koha mesatare “Më e shkurtër se afati procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve”, pikëzimi me 15 pikë.

“Aftësia e gjyqtarit për të kryer procedurat gjyqësore”

“Numri mesatar i seancave për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive” – Në total, referuar burimeve të vlerësimit ka rezultuar se çështjet e vëzhguara me palë kundërshtare variojnë nga 1 deri në 7 seanca gjyqësore. Në total numri mesatar i seancave është 3.4 seanca për të gjitha kategoritë e çështjeve, duke e kaluar me 0.4 seanca.

Nga vëzhgimi i 10 dosjeve rezulton se gjyqtarja ka kryer me korrektësi të gjitha veprimet procedurale për planifikimin dhe zhvillimin në kohë dhe me efektivitet të seancave gjyqësore duke respektuar në çdo rast ligjin procedural civil dhe penal. Përgjithësisht shtyrjet e seancave gjyqësore kanë ndodhur për shkaqe procedurale të tilla si: njoftimi i mbrojtësit të të pandehurit, marrje e informacionit dhe provave nga të tretët, kryerja e akteve të ekspertimeve, njoftimi i ekspertit etj.

Në lidhje me pikëzimin për këtë tregues, në Metodologjinë e Pikëzimit parashikohet se të dhënat statistikore analizohen sipas situatës me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit në tërësinë e tyre, veçanërisht masave për zhvillimin me efektivitet dhe produktivitet të seancave gjyqësore në çështjet e përzgjedhura me short, rezulton se gjyqtarja në çdo rast ka marrë të gjitha masat e nevojshme për shmangien e seancave joproduktive, planifikimin dhe zhvillimin e seancave në kohë. Prandaj pavarësisht se numri mesatar i seancave është më i lartë se

3, duke e tejkeluar këtë tregues vetëm me 0.4 seanca, gjyqtari duhet të pikëzohet me 15 pikë, sepse ajo ka treguar shkallë të lartë aftësie për shmangien e seancave gjyqësore joproductive.

Për këtë nënkriter është propozuar vlerësimi i saj me 15 pikë.

“Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor” – Referuar burimeve të vlerësimit, në dosje te vëzhguara, seancat e planifikuara janë çelur në kohë. Janë kryer të gjitha veprimet procedurale duke i caktuar në afat të shkurtër dhe duke i caktuar seancat ndërmjet njëra-tjetrës në një kohë të shkurtër (përveçse gjatë kohës kur ka qenë leja vjetore, që ka kaluar afati për 1 muaj).

Për sa i përket seancave të çelura me vonesë, rezulton një numër prej 9 seancash të cilat kanë filluar me vonesë nga 18 minuta deri në 45 minuta dhe në çdo rast gjyqtarja ka relatuar shkaqet e fillimit me vonesë. Shkaku i vonesave, sipas relatimit lidhet me pjesëmarrjen e saj në gjykime të tjera të përfunduara tej afatit të parashikuar, shoqërimi me vonesë i të pandehurve nga toga e shoqërimit, apo edhe në pritje të zhvillimit të seancës gjyqësore me sistemin audio duke qenë se sallat e gjykimit kanë qenë të zëna me gjykime të tjera, apo problemeve me sistemin e regjistrimit audio.

Pasur parasysh edhe faktin se në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat kanë qenë tre salla dhe në ato kanë gjykuar 10 gjyqtarë.

Referuar sa më sipër, vlerësoj se shkalla e aftësisë për këtë tregues, “Kryerja e veprimeve procedurale për organizimin e procesit gjyqësor”, duhet të vlerësohet si shumë e lartë duke e pikëzuar me 20 pikë.

Aftësia e gjyqtares për sa i përket “Rregullshmërisë së dokumentacionit të dosjeve” – Rezulton nga aktet e vlerësimit se renditja e dosjeve në çështjet penale fillon me aktin e shortit, vijon me vendimin e kalimit të çështjes në seancë gjyqësore, njoftimet në rend kronologjik, diskutimet me shkrim të palëve, procesverbalet e seancave sipas datave dhe mbyllet me vendimin gjyqësor përfundimtar.

Renditja e dosjes në çështjet civile fillon me aktin e shortit, vijon me padinë dhe provat e paraqitura nga palët, vendimin e gjyqtares për caktimin e seancës përgatitore, aktet e njoftimit të palëve, procesverbalet, kërkesat dhe parashtrimet me shkrim, etj.

Brenda kategorisë, aktet renditen sipas datave. Renditja e akteve në dosje, e cila është përgjithësisht e njëjtë, është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen lehtësisht të aksesueshme.

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka shkallë aftësie shumë të lartë dhe për këtë arsye duhet të pikëzohet me 5 pikë.

“Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit”- Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë aftësie në këtë tregues. Për këtë arsye është propozuar pikëzimi i saj me 10 pikë.

Në total, niveli i vlerësimit dhe pikëzimit për kriterin “Aftësia organizative e gjyqtares” është propozuar "Shkëlqyeshëm", me 100 pikë.

“Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale” - Në relacionet e hartuara nga Inspektorati i KLD rezulton se shkak i referimit për t’u mbajtur në konsideratë në vlerësimin etik dhe profesional ka qenë kohëzgjatja e gjyqimit të çështjeve.

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja reflekton angazhim dhe përgjegjësi në funksion dhe nuk rezulton asnjë sjellje që mund të cenojë etikën në punë. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion, duke u pikëzuar me 35 pikë.

“Integriteti i gjyqtares” – Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja gëzon integritet të lartë. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të integritetit, si dhe nuk rezulton asnjë e dhënë për sjellje të pahijshme, apo sjellje që cenojnë nderin dhe dinjitetin e saj, kështu është propozuar pikëzimi i saj me 40 pikë.

Për sa i përket “Paanësisë së gjyqtares”, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose në përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese, dhe është propozuar pikëzimi i saj me 10 pikë.

Për sa i përket nënkriterit “Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares”, duke iu referuar tërësisë së akteve të administruara në dosjen e vlerësimit nuk rezultojnë të dhëna që në këto çështje të jenë paraqitur kërkesa për përjashtimin e gjyqtares. Prandaj për këtë tregues vlerësoj se numri i kërkesave të

pranuara të palëve për përjashtimin e gjyqtares, duhet të vlerësohet si i pakonsiderueshëm, duke e pikëzuar me 15 pikë.

Niveli i vlerësimit për këtë kriter “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale” është propozuar “Shkëlqyeshëm” dhe pikëzuar me 100 pikë.

“Aftësitë personale dhe angazhimi profesional të gjyqtares” – konkretisht, “Aftësia e komunikimit”, “Komunikimi i qartë dhe transparent”.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka komunikim të qartë dhe transparent me pjesëmarrësit në gjykim, si dhe në gjuhën e përdorur në arsyetimin e vendimeve.

Për këtë arsye është propozuar pikëzimi i saj me 25 pikë.

“Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale” - Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të të dhënave personale dhe për rrjedhojë, prezumohet se gjyqtarja ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

Kështu, aftësia e gjyqtares është shumë e lartë, duke e pikëzuar me 15 pikë.

“Aftësia për të bashkëpunuar”, “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët”- Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe mungesës së të dhënave për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtares me kolegët, prezumohet se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta. Për këtë arsye është propozuar pikëzimi i saj me 15 pikë.

“Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën” - Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe mungesës së të dhënave për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtares me administratën gjyqësore, prezumohet se shkalla e komunikimit është shumë e lartë. Për këtë arsye edhe për këtë nënkriter është propozuar pikëzimi i saj me 10 pikë.

“Gatishmëria e gjyqtares për t’u angazhuar në veprimtari të tjera”, konkretisht “Pjesëmarrja e gjyqtares në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale” – Referuar burimeve të vlerësimit rezulton se gjyqtarja është angazhuar në aktivitete trajnuese në cilësinë e pjesëmarrëses në 30

aktivitete të zhvilluara në gjithë periudhën e vlerësimit, gjithsej 51 ditë. Gjithashtu ka marrë pjesë në trajnime jashtë sistemit të Shkollës së Magjistraturës.

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se ka një angazhim të lartë, për këtë arsye është propozuar pikëzimi i saj me 20 pikë.

“Disponueshmëria e gjyqtares për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë” - Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton që gjyqtarja të jetë angazhuar në aktivitete trajnuese si eksperte/lehtësuese ose në angazhimin e saj për udhëhequr kandidatët për gjyqtarë. Për këtë arsye, referuar Metodologjisë së Pikëzimit është vlerësuar me 3 pikë duke qenë se nuk ka të dhëna.

Për sa i përket “Angazhimit të gjyqtares në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun”, referuar burimeve të vlerësimit si më sipër, si dhe formularit të vetëvlerësimit profesional të gjyqtares, si dhe akteve të paraqitura nga gjyqtarja lidhur me këtë tregues, rezulton është angazhuar në veprimtari ndërinstitucionale. Konkretisht ka rezultuar se në vitin 2013 deri në muajin korrik të vitit 2014 gjyqtarja është angazhuar si pedagoge e jashtme në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti Privat “{...}”, referuar vërtetimit nr.{...} Prot., datë 14.01.2013 të Universitetit “Kristal”, si dhe vendimit nr.502/2022.

Për sa më sipër, për këtë kriter, duke qenë se ka të dhëna, është propozuar pikëzimi i saj me 5 pikë.

Për sa i përket nënkriterit të “Publikimeve ligjore” nuk rezultojnë të dhëna që gjyqtarja të ketë publikime ligjore. Për këtë arsye është propozuar pikëzimi i saj me 0 pikë.

Në tërësi, vlerësimi i gjyqtares për “Aftësitë profesionale dhe angazhimin profesional”, propozohet "Shkëlqyeshëm", duke e pikëzuar me 93 pikë.

Propozimi për të katër nënkriteret është "Shkëlqyeshëm", me 393 pikë.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë, keni ndonjë diskutim?

Nëse jo, kalojmë në votimin e projekt-raportit sipas propozimit të ardhur nga relatorja.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional, me qëllim gradimi, të gjyqtarës {...}, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:

- A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
- B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
- C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
- D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.

Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.

2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

* * *

(Pika 11 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 19.09.2022)

Pika 12 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarës {...}, për periudhën 2017-2019”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Brikena Ukperaj).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:48 dhe mbaroi në orën 13:57.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Irena Plaku*** (anëtare)
6. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
7. ***Alban Toro*** (anëtar)
8. ***Brikena Ukperaj*** (anëtare)
9. ***Marçela Shehu*** (anëtare)
10. ***Yllka Rupa*** (anëtare)

Shënim: Zoti Dritan Hallunaj nuk merr pjesë në trajtimin e çështjes.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
2. *Denisa Varfi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
3. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
4. *Përfaqësues nga Universiteti “Epoka”.*
5. *Staf administrativ i KLGJ-së; Media KLGJ.*
6. *Valbona Bala, USAID.*
7. *Edmond Hoxhaj.*

RENDI I DITËS:

12. Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarës {...}, për periudhën 2017-2019”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Brikena Ukperaj).

Naureda Llagami: Atëherë, kalojmë tek projekt-akti i radhës. Edhe kjo ka të bëjë me raportin e vlerësimit për periudhën profesionale të gjyqtarës {...}, për periudhën 2017–2019.

Për më shumë detaje, fjalën ia jap zonjës Ukperaj.

Brikena Ukperaj: Faleminderit zonja Kryetare!

Projektraporti i vlerësimit të gjyqtarës {...} vjen si rezultat i procedurës së vlerësimit normale të gjyqtarës sipas programit të vitit 2021, periudha e vlerësimit 2017 – 2019. Projektraporti shoqërohet nga raporti analitik i përgatitur nga nëpunësi përgjegjës për vlerësimin. I janë njoftuar rregullisht gjyqtarës aktet. Ajo është shprehur dakord. Nuk ka pasur kundërshtime, nuk ka kërkuar të dëgjohet në seancë dëgjimore në Këshill dhe nuk ka pasur kërkesë për prova të reja.

Vlen të theksohet që në kuadër të burimeve të vlerësimit për efekt të këtij vlerësimi janë përfshirë edhe rezultatet e verifikimit të një çështjeje që ishte transferuar nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit {...} dhe në kushtet

kur vendimi ishte dhënë gjatë kësaj periudhe vlerësimi, ne vlerësuam (sikundër edhe në procesin e gradimit), që rezultatet e këtij verifikimi të analizoheshin në kuadër të vlerësimit periodik të gjyqtarës.

Jeni njohur të gjithë edhe me raportin analitik edhe me projektraportin e vlerësimit, kështu që do të ndalem në mënyrë të sintetizuar vetëm në rezultatet lidhur me secilën nga katër kriteret e vlerësimit.

Për sa i përket kriterit të parë që ka të bëjë me “Aftësitë profesionale të gjyqtarit”, gjyqtarja vlerësohet maksimalisht për sa i përket “Aftësisë për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave”; aftësisë jo vetëm për të identifikuar por edhe për të interpretuar ligjin civil, penal, procedural dhe atë material; aftësisë për të qenë e qartë, koncize, dhe e kuptueshme në të gjitha vendimet e saj. Të gjitha vendimet përmbajnë një strukturë të mirëorganizuar dhe që siguron një rrjedhë logjike të mendimit të gjyqtarit. Njëkohësisht aftësia maksimale e gjyqtarës edhe për sa i përket “Cilësisë së analizës dhe e argumentimit logjik” ku vlen të theksohet se kjo analizë ndjek rregullin fakt–normë–interpretim–konkluzion dhe krijon një pamje të qartë të zhvillimit të mendimit juridik në mënyrën e organizimit dhe paraqitjes së procesit analitik dhe logjik të arsytimit. Në secilin vendim të analizuar, mendimi logjik ka vijueshmëri, mbështetet në interpretimin e ligjit të zbatueshëm, si dhe pasurohet me qëndrimet e praktikës gjyqësore dhe integrimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës. Arsyetimi është i qartë, i plotë dhe është gjithëpërfshirës, si në aspektin procedural kur ngrihen çështje për diskutim, ashtu edhe në atë thelbësor dhe në çdo vendim gjen një përgjigje të argumentuar lidhur me mënyrën e zgjidhjes së çështjes.

Përfundimisht, për kriterin e parë të “Aftësive profesionale”, propozohet niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm", pikët 100.

Për sa i përket kriterit të dytë “Aftësisë organizative të gjyqtarit”, përqindja e çështjeve të gjykuara jashtë afatit rezulton 4.93 %, kanë qenë 223 çështje për të cilat vetëm në 11 çështje është tejkalar afati ligjor, tejkallim pothuajse i pakonsiderueshëm. Gjithsesi, referuar Metodologjisë ai nuk ka ndikim dhe gjyqtarja pikëzohet me 15 pikë.

Për sa i përket “Plotësimin të standardeve minimale kohore”, përqindja e çështjeve të gjykuara tej standardeve, sipas kategorive është 9.12% dhe sipas Metodologjisë pikëzohet me 5 pikë.

Për sa i përket “Kohës mesatare që i dedikohet çdo çështjeje”, rezulton më e shkurtër për të gjitha kategoritë e çështjeve, me përjashtim të çështjeve materiale ku tejkalimi rezulton vetëm me dy ditë, çka është një tejkalim i papërfillshëm që nuk ndikon në nivelin e vlerësimit. Propozohet pikëzimi maksimal edhe për këtë tregues.

Për sa i përket “Rendimentit”, ka rezultuar 104.9 %. Propozohet vlerësimi maksimal me 10 pikë.

Për sa i përket “Kohës mesatare të arsyetimit të vendimit përfundimtar”, ka pasur një diskutim sepse ka rezultuar që data e depozitimit në sekretari të dosjeve gjyqësore që lidhen me hetimet paraprake, masa sigurimi, përgjime, rezultojnë të depozituara tej afatit të parashikuar në ligj, por duke marrë parasysh shpjegimet e gjyqtarës dhe natyrën e këtyre çështjeve, është konsideruar që të mos konsiderohet data e vendimit të arsyetuar data kur dosja depozitohet në sekretari për ruajtjen e sekretit të hetimit por data kur ajo i është dorëzuar prokurorisë, sepse masat e ekzekutimit dhe përgjimet janë vënë në ekzekutim.

Për këtë arsye është konsideruar edhe këtu që pikëzimi duhet të jetë maksimal.

Për sa i përket “Aftësisë për të kryer procedurat gjyqësore”, “Numri mesatar i seancave” ka rezultuar 5 seanca, por gjithsesi gjyqtarja ka marrë të gjitha masat për shmangien e seancave joproduktive. Aftësia e gjyqtarës shumë e lartë, 15 pikë.

Për sa i përket “Kryerjes së veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor”, këtu ka pasur të dhëna të cilat kanë afektuar nivelin e vlerësimit sepse ka rezultuar që për çështjet civile të regjistruara pas hyrjes në fuqi të ndryshimit të Kodit të Procedurës Civile gjyqtarja nuk i ka kryer me efektivitet detyrat që duhet të kryente në fazën paragjykimore duke sjellë që shumicën e këtyre detyrave e ka realizuar në gjykim dhe kjo ka pasqyruar edhe zvarritje të gjykimit, që ka të bëjë me caktimin e ekspertit, me marrjen e provave të të tretëve apo me saktësimin e objektit të padisë. Aftësia për këtë shkak është propozuar mbi mesatare dhe pikëzimi 16 pikë.

“Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes” dhe “Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit”, nuk ka pasur të dhëna që mund të afektonin vlerësimin për këto dy tregues, prandaj propozohet vlerësimi maksimal.

Në tërësi, për kriterin e “Aftësive organizative”, niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”, pikët 96.

Për sa i përket të kriterit të tretë që ka të bëjë me “Etikën në punë dhe angazhimin në funksion”, “Integritetin”, “Paanësinë”, nuk ka pasur të dhëna; nuk ka pasur asnjë ankesë gjatë periudhës 2017–2019; nuk ka pasur masa disiplinore. Referuar raportit të ILDKPKI-së nuk ka të dhëna për konfliktin e interesit. Ndërkohë, për sa i përket çështjes së analizuar nga ILD-ja referuar të dhënave të transferuara nga KPK-ja, ka rezultuar që ato nuk përmbajnë të dhëna që mund të afektojnë vlerësimin e saj por as që përbëjnë shkelje të rënda profesionale, për arsye sepse ato kanë të bëjnë me mënyrën e vlerësimit të provave nga ana e gjykatës, duke marrë parasysh që ky vendim i gjykatës së shkallës së parë është lënë në fuqi nga ana e gjykatës së apelit, ILD-ja ka vendosur arkivimin e ankimit. Nuk ka asnjë të dhënë që mund të merret parasysh në vlerësimin e gjyqtarës.

Përfundimisht për kriterin e tretë “Etika dhe angazhimi profesional i gjyqtarës”, pikat janë 100 dhe propozoj nivelin e vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Për sa i përket kriterit të katërt të “Aftësisë personale dhe angazhimit profesional”, pikëzohet maksimalisht për “Aftësinë e komunikimit”, “Aftësinë e bashkëpunimit me kolegët dhe me administratën gjyqësore”, si dhe për “Pjesëmarrjen në programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës”. Rezulton që gjyqtarja gjatë kësaj periudhe vlerësimi 2017–2019 ka kontribuar në programin e trajnimit vazhdues të shkollës në cilësinë e lehtësueses në katër trajnime çfarë ka ndikuar edhe në pikëzimin e treguesit përkatës.

Nuk ka të dhëna për bashkëpunim ndërinstitucional. Nuk ka të dhëna për publikime.

Përfundimisht, për kriterin e katërt, “Aftësitë personale dhe angazhimit profesional”, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm", pikët 93.

Si përfundim, në cilësinë e relatores në procedurën e vlerësimit, propozoj: Për kriterin e parë “Aftësitë profesionale”, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm" – 100.

Për kriterin e dytë “Aftësitë organizative”, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm" – 96.

Për kriterin e tretë “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm" – 100.

Për kriterin e katërt “Aftësitë personale dhe angazhimit profesional”, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm", pikët 93.

Përfundimisht, niveli i përgjithshëm "Shkëlqyeshëm"- pikët 389.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit zonja Ukperaj!

Atëherë, nëse nuk keni ndonjë diskutim, kalojmë në votim.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Miratimin e "Raporti i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarës {...}, për periudhën 2017–2019", duke e vlerësuar atë si më poshtë:

- A. Aftësitë profesionale – "Shkëlqyeshëm";
- B. Aftësitë organizative – "Shkëlqyeshëm";
- C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – "Shkëlqyeshëm";
- D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – "Shkëlqyeshëm".

Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – "Shkëlqyeshëm".

2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

* * *

(Pika 12 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 19.09.2022)

Pika 13 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për mbarimin e statusit të magjistratit të gjyqarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë , z. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:48 dhe mbaroi në orën 13:57.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Irena Plaku*** (anëtare)
6. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
7. ***Alban Toro*** (anëtar)
8. ***Brikena Ukperaj*** (anëtare)
9. ***Marçela Shehu*** (anëtare)
10. ***Yllka Rupa*** (anëtare)

Shënim: Zoti Dritan Hallunaj nuk merr pjesë në trajtimin e çështjes.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
2. *Denisa Varfi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
3. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
4. *Përfaqësues nga Universiteti “Epoka”.*
5. *Staf administrativ i KLGJ-së; Media KLGJ.*
6. *Valbona Bala, USAID.*
7. *Edmond Hoxhaj.*

RENDI I DITËS:

13. Shqyrtimi i projektvendimit “Për mbarimin e statusit të magjistratit të gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë , z. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Naureda Llagami: Kalojmë në çështjen e fundit të rendit të ditës, që ka të bëjë me mbarimin e statusit të magjistratit të gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë , z. {...}.

Klodian Kurushi: Faleminderit Kryetare!

Të nderuar kolegë!

Është paraqitur kërkesë për dorëheqje nga statusi i magjistratit nga zoti {...}, që është gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Në mënyrë të përmbledhur do të bëja vetëm një parashtrim të shkurtër, pasi zoti {...} e ka ripërsëritur kërkesën për dorëheqje. Ne e kemi marrë në shqyrtim herën e parë dhe më pas ai ka hequr dorë nga kërkesa për dorëheqje, por motivet e kërkesës janë të njëjta.

Kështu që, në këtë rast, unë do të bëja vetëm një prezantim shumë të shkurtër, por nëse kolegët kanë diçka për të shtuar, për të kërkuar, jam në dispozicion për të sqaruar çdo moment të këtij relacioni që kemi përgatitur.

Kërkesa e paraqitur nga zoti {...} mban datën 13.09.2022. Ndër të tjera zoti {...} ka parashtuar motivin për heqjen dorë nga statusi i magjistratit duke argumentuar se ai aktualisht është i impenjuar si pedagog pranë një universiteti jopublik dhe kjo për shkak të eksperiencës shumëvjeçare edhe akademike në fushën e së drejtës si lektor në universitet, lehtësues dhe ekspert pranë Shkollës së Magjistraturës. Në kushtet e fillimit të vitit të ri akademik si dhe ndodhur para faktit që marrëveshja e ofruar nga universiteti jopublik përmbush pritshmëritë e tij, ka vendosur të ndërpresë karrierën duke paraqitur kërkesën për heqjen dorë nga statusi.

Ne mendojmë si Komision që kërkesa është mbështetur në nenin 65 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar: “1. Magjistrati mund të kërkojë mbarimin e statusit, nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes para Këshillit përkatës. 2. Dorëheqja duhet të jetë me shkrim dhe nuk është e nevojshme të jetë e arsyetuar. Dorëheqja jep efektet në fund të muajit pasardhës, nga dita kur Këshilli merr deklarinimin me shkrim të dorëheqjes. Mbarimi i statusit të magjistratit deklarohet me vendim të Këshillit jo më vonë se dy javë nga mbarimi i statusit.”

Kemi përgatitur edhe projektvendimin përkatës në lidhje me atë çfarë thamë më sipër. Projektvendimi është i renditur në katër pika dhe e kemi vënë përpara mbledhjes së sotme për t’u marrë në shqyrtim.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit zoti Kurushi!

Atëherë, nëse nuk keni ndonjë diskutim, kalojmë në votimin e projekt-aktit sipas propozimit të ardhur.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për shkak të dorëheqjes së tij.

2. Efektet e vendimit fillojnë më datë 31.10.2022.

3. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet gjyqtarit z. {...} sipas kërkesave të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Me kaq po e mbyllim mbledhjen për sot.

Faleminderit!

Punë të mbarë!

* * *

(Pika 13 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor